



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 51 regjistër (JR)
Datë 08.09.2021

Nr. 6 i vendimit
Datë 07.02.2024

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar
Mimoza Tasi	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 07.02.2024, ditën e mërkurë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Olsi Xhavella, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Korçë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 357, datë 18.03.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Nenet C, Ç, D e në vijim të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 42 dhe 179/b, pika 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në datën 07.02.2024, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në ankim, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 357, datë 18.03.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Olsi Xhavella, (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të funksionit gjyqtar në Gjykatën e Apelit Korçë, në bazë të nenit 179/b, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 84/2016, iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka plotësuar dhe dërguar brenda afatit ligjor në organet përkatëse ndihmëse, deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit (në vijim deklarata *vetting*), në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), deklaratën për kontrollin e figurës pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).
3. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka administruar raportet e hartuara nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLGj-ja, sipas të cilave ka rezultuar si më poshtë.
 - 3.1. ILDKPKI-ja¹, në zbatim të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
 - 3.2. DSIK-ja², sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Olsi Xhavella.
 - 3.3. KLGj-ja ka rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumentet e tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi rastësor dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGj-së, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit³.

¹ Raporti nga ILDKPKI-ja dërguar me shkresën nr. {***} prot., datë 05.06.2018.

² Raporti nga DSIK-ja dërguar me shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2017. Raporti është deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë 19.11.2022, të KDZh-së.

³ Raporti nga KLGj-ja dërguar me shkresën nr. {***} prot., datë 14.02.2019.

4. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse si më sipër, Komisioni kreu procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Në përfundim të procedimit administrativ, pas një vlerësimi tërësor të procedurave, sipas paragrafit 2, të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Olsi Xhavella ka arritur nivel të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, duke u gjendur në kushtet e pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, dhe ka marrë vendimin nr. 357, datë 18.03.2021.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Me vendimin nr. 357, datë 18.03.2021, Komisioni ka vendosur: “*Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Olsi Xhavella, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Korçë*”. Ky vendim është mbështetur në konkluzionet e mëposhtme.

5.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: *subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer deklaram të saktë të pasurive dhe interesave privatë, si dhe nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij, nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e pasurive (gjendjet e likuiditeteve në llogari bankare dhe cash) dhe kryerjen e shpenzimeve përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar detyrën si gjyqtar.*

- *Për pasurinë apartament me sipërfaqe 85 m², subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e saj, sipas përcaktimeve të germës “b”, të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk arriti të provojë se kredia e përfituar në vlerën 15.000 euro është përdorur si burim për blerjen e kësaj pasurie, si dhe nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të pretenduar si e ardhur nga nëna e tij në vlerat 700.000 lekë dhe 1.200 euro.*
- *Për pasurinë apartament me sipërfaqe 111,51 m², subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e saj, sipas përcaktimeve të germës “b”, të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të pretenduar në shumën prej 2.000 eurosh si pagesë e këstit të parë dhe dhurimin nga vjehri në shumën prej 1.000.000 lekësh në vitin 2010.*
- *Nga analiza financiare për vitet 2003-2016, rezultuan balanca negative vjetore për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive: për vitin 2004 në vlerën (-) 350.847 lekë; për vitin 2010 në vlerën (-) 560.903 lekë; për vitin 2014 në vlerën (-) 260.698 lekë; për vitin 2015 në vlerën (-) 224.540 lekë. Subjekti ka pamundësi financiare për blerjen e pasurive, për të përballuar me burime të ligjshme financiare kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve, ndër vite, duke rezultuar me një mungesë burimesh të ligjshme në vlerën (-) 1.396.988 lekë, duke u gjendur në kushtet e përcaktimeve të germës “b”, të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.*

5.2. Për kriterin e vlerësimit të figurës: *nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të*

rivlerësimin rezultuan të sakta dhe të vërteta, subjekti i rivlerësimin ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

5.3. Për vlerësimin e aftësive profesionale: *subjekti i rivlerësimin ka arritur nivel minimal kualifikues, në kuptim të germës “c”, të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.*

III. Shkaqet e ankimit

6. Subjekti i rivlerësimin Olsi Xhavella, në respektim të afateve dhe kërkesave ligjore, më datë 28.05.2021, ka ushtruar ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimin (në vijim “Kolegji”), kundër vendimit të sipërcituar të Komisionit, për aspekte procedurale dhe për themelin. Në kërkimin përfundimtar, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimin kërkoi gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, ndryshimin e vendimit nr. 357, datë 18.03.2021, të Komisionit dhe konfirmimin e tij në detyrë.

7. Lidhur me procesin e rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimin, në mënyrë të përmbledhur, subjekti i rivlerësimin parashtroi:

7.1. Komisioni, me vendimin e marrë dhe procedurën joligjore të ndjekur, i ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në bazë të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Hetimi i kryer ka qenë i njëanshëm dhe është realizuar në kundërshtim të plotë me normat procedurale dhe në zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Në proces dhe në vendimmarrjen e Komisionit nuk kanë gjetur respektim të plotë parimet e ligjshmërisë, drejtësisë dhe paañësisë, barazisë para ligjit, mbrojtjes juridike dhe lirive e të drejtave Kushtetuese, të proporcionalitetit, të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

7.2. Interpretimi dhe vlerësimi i konstatimeve prej Komisionit është tej qëllimit të kuadrit kushtetues e ligjor dhe, në përgjithësi, jo në frymën e reformës në drejtësi me qëllim rikthimin e besimit të publikut. Provat e depozituara pas njohjes me raportin përfundimtar të hetimit administrativ, argumentet e parashtruara me shkrim dhe në seancë dëgjimore nuk u morën në konsideratë dhe u anashkaluan me një arsyetim të përciptë dhe jobindës. Analiza e pasurisë është rezultat i një gjykimi të njëanshëm, duke u mbështetur vetëm në provat që Komisioni ka mbledhur, pa analizuar dhe shqyrtuar provat dhe argumentet e paraqitura prej tij.

7.3. Mosaplikimi i parimit kushtetues të dyfishit të pasurisë së ligjshme cenon parimin e sigurisë juridike. Kërkesa për të justifikuar pasurinë, kur ligji nuk e ngarkon subjektin për të zbatuar masa të veçanta kujdesi, për shkak se ai nuk bënte më parë pjesë në kategorinë e personave të dyshuar apo që duhej të justifikonin pronën, por i kalon vetë subjektit barrën e provës, përbën një dhunim të së drejtës për t’u mbrojtur, garantuar nga Kushtetuta, pasi barra e provës i takon akuzës ose palës që ngre dyshimin.

7.4. Analiza financiare e vënë në dispozicion gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe në vendimin përfundimtar, paraqet vetëm konkluzionet e arritura por jo metodologjinë, veçanërisht për mënyrën e përlogaritjes së shpenzimeve, për rrjedhojë ka qenë në pamundësi objektive për të verifikuar saktësinë e përlogaritjes së tyre.

8. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në mënyrë të përmbledhur, subjekti i rivlerësimit parashtroi:

8.1. Në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 85 m², ndodhur në qytetin e Korçës, blerë në vitin 2004, në vlerën 2.900.000 lekë

- i) Shuma e kredisë bankare prej 15.000 eurosh, e përfituar në vitin 2004, është përdorur ekskluzivisht për pagimin e një pjese të çmimit të pasurisë apartament të krijuar në të njëjtin vit. Lidhur me faktin që kontrata e kredisë mban një datë të mëvonshme në raport me kontratën e shitblerjes së pasurisë, me provat e paraqitura, shpjegimet e hollësishme dhe argumentet bindëse, referuar rrethanave objektive dhe kontekstit të kryerjes së veprimeve përkatëse, ka provuar në mënyrë të padyshimtë që mospërputhja në kohë është e justifikueshme.
- ii) Shumat e paguara nga personi i lidhur, nëna, prej 700.000 lekësh dhe prej 1.200 eurosh, të siguruara nga të ardhurat nga punësimi në emigracion, objektivisht të pamundura për t'i provuar, duhet të shihen ngushtë me rrethanat sociale dhe familjare, krejtësisht specifike në rastin e tij.

8.2. Në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 111,51 m², në Korçë

- i) Lidhur me shumën 2.000 euro, paguar në momentin e lidhjes së kontratës, është anashkaluar dinamika dhe fleksibiliteti i marrëdhënieve familjare, në kuptim të organizimit të jetës ekonomike, si dhe nuk janë vlerësuar pakujdesi të tij, sa i përket pasqyrimin të kursimeve modeste në fund të çdo viti të deklaramin të pasurisë.
- ii) Lidhur me mundësitë financiare të personit tjetër të lidhur, babait të bashkëshortes, për dhënien në formën e prikës të shumës prej 1.000.000 lekësh në fund të vitit 2010, analiza financiare nuk merr në konsideratë të ardhurat e përfituara prej familjes përpara vitit 2006, si dhe shpenzimet e jetesës përlllogariten në mënyrë statike, pa marrë parasysh asnjë rrethanë tjetër. Të ardhurat nga paga të personit të lidhur, bashkëshortes, para martesës, në shumën prej 569.665 lekësh janë të gjitha kursime dhe pjesë e kësaj shume, pasi shpenzimet e jetesës së saj janë përballuar nga familja.

8.3. Në lidhje me automjetin tip BMW, me targa {*}, blerë në datën 14.06.2003, në vlerën 250.000 lekë, shitur në datën 26.05.2006, në po të njëjtën vlerë**

- i) Referuar analizës financiare për vitin 2003, bilanci rezulton pozitiv, për rrjedhojë blerja e kësaj pasurie ka qenë e përballueshme edhe duke mos marrë në konsideratë kontributin e nënës me të ardhura nga emigracioni.

8.4. Në lidhje me analizën financiare

- i) Për vitin 2010, rezultati negativ buron nga pasqyrimi i zërit “ndryshim në likuiditet” për shumën 946.956 lekë, e cila nuk ka logjikë ekonomike dhe nuk kuptohet përse është pasqyruar, përveçse duke marrë në konsideratë dhuratën e familjarëve të bashkëshortes për shumën 1.000.000 lekë. Nëse kjo shumë e dhuruar nuk njihet për shkak të pamundësive financiare të dhuruesve, dhe referuar faktit që nuk ka shërbyer për krijimin e ndonjë pasurie apo kryerjen e ndonjë shpenzimi për vitin korrespondues, ajo nuk duhet të merret në

konsideratë dhe pjesë e analizës të mbeten të ardhurat e tjera. Referuar raportit të ardhurash-penzime për vitin 2010, balanca rezulton pozitive dhe në mënyrë alogjike rezulton diferencë negative e pajustificuar.

- ii) Për vitin 2014, evidentimi i zërit të emërtuar “Hua nga ShKK “{***}” - Sh. Xh. - 500.000 lekë” dhe në pasqyrën korresponduese shuma (-) 453.000 lekë është e pasaktë. Kontrata e kredisë për shumën 500.000 lekë e datës 09.08.2013, marrë nga bashkëshortja pranë Shoqërisë së Kursim Kreditit “{***}”, Dega Korçë, pas zgjatjes së afatit të shlyerjes së saj, sipas praktikës së shoqërisë, është evidentuar në një kredi të re që mban datën 29.04.2014. Kontrata e kredisë e datës 29.04.2014 ka përlllogaritur diferencën e mbetur pa shlyer të kredisë të datës 09.08.2013, deri në atë moment, me kushte të tjera sa i përket afatit dhe këstit mujor, pra, është vazhdim (ristrukturim) i kredisë së parë.
- iii) Për vitet 2004 dhe 2015, nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat e përfituara nga dietat dhe në zërin “shpenzime jetese” nuk janë zbritur shpenzimet që i korrespondojnë ditëve për të cilat është trajtuar me dietë. Për udhëtimet në Greqi, shpenzimet kanë qenë minimale për shkak të ofrimit të mikpritjes nga të afërmit dhe për ditët e qëndrimit duhet të zbriten shpenzimet për jetesë, pasi rezultojnë të dubluara. Për udhëtimet njëditore, për arsye pune në Gjirokastrë (delegime pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë), ka zgjedhur të udhëtojë duke përshkruar një pjesë të itinerarit nga territori grek dhe është trajtuar me dietë. Për të njëjtat ditë nuk është aplikuar zbritja e shpenzimeve për jetesë dhe të udhëtimeve jashtë shtetit, duke u shtuar në mënyrë artificiale shpenzime të mbuluara nga dieta.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

- 9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion, (*ratione materiae*), për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Olsi Xhavella, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

- 10. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

- 11. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit, kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e nenit 51

të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 357, datë 18.03.2021, të Komisionit, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, më datë 07.02.2024.

B. Mbi shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor

12. Subjekti i rivlerësimit pretendon se procesi është zhvilluar në kundërshtim me parimet e procesit të rregullt ligjor, pasi hetimi i kryer ka qenë i njëanshëm, i realizuar në kundërshtim të plotë me normat procedurale dhe në zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Në proces dhe vendimmarrjen e Komisionit nuk kanë gjetur respektim të plotë parimet e ligjshmërisë, drejtësisë dhe paanësisë, barazisë para ligjit, mbrojtjes juridike dhe lirive e të drejtave Kushtetuese, proporcionalitetit dhe parimi për një proces të rregullt ligjor.

12.1. Duke referuar në kriteret e përcaktuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, (në vijim “GjEDNj”), në çështjen *Volkov kundër Ukrainës*, qëndrime të mbajtura nga kjo gjykatë në çështje të tjera dhe dokumente të tjerë të organizmave ndërkombëtarë⁴, subjekti i rivlerësimit ngre pretendime lidhur me Komisionin, për shkak të mospërfaqësimit të gjyqtarëve nga sistemi gjyqësor në momentin e emërimit të tyre, për mënyrën e emërimit të anëtarëve nga Kuvendi, pa përfshirjen e trupës gjyqësore, për statusin e dyfishtë hetues dhe vendimmarrës, si dhe mandatin e limituar, pa mundësi riemërimi apo zgjatje. Lidhur me garancitë e synuara nga aktet ndërkombëtare, lidhur me pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit, të drejtën për t’u gjykuar nga një gjykatë e krijuar me ligj, moscënimin e të drejtës për t’u mbrojtur e, në këtë perspektivë, parashtrimet e subjektit për mosgarantimin e tyre nga Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit i vlerëson të pabazuara.

12.2. Këto pretendime të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit Olsi Xhavella janë trajtuar gjerësisht prej Kolegjit në jurisprudencën e tij, duke nënvizuar se kuadri ligjor i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve i është nënshtuar vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ekspertizën e Komisionit të Venecias⁵. Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar pajtueshmërinë me Kushtetutën të ligjit nr. 84/2016 dhe ofrimin nga organet e procesit të rivlerësimit të të gjitha garancive të nevojshme për zhvillimin dhe respektimin e një procesi të rregullt ligjor⁶. Konkretisht, në vendimin nr. 2, datë 18.01.2017, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrim se [...] 67. *Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra, organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrojnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se këto organe ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së [...]. Në funksion të zbatimit të të drejtave të procesit të rregullt, në të njëjtën linjë*

⁴ Subjekti referon vendimet e GjEDNj-së çështjet: *Ramos Nunes de Carvalho e S kundër Portugalisë; Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës; Denisov kundër Ukrainës; Astradsson kundër Islandës, Kartën Evropiane mbi Statutin për Gjyqtarët, “Raporti mbi pavarësinë e Sistemit Gjyqësor”, miratuar më 12-13.03.2010.*

⁵ *Opiniononi CDL - AD (2016)03610.*

⁶ *Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 2, datë 18.01.2017 dhe nr. 78, datë 12.12.2017.*

arsyetimi, GjEDNj-ja në vendimin që i përket *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*⁷, ka mbajtur qëndrim se [...] nuk ka asnjë ngatërresë mes detyrimit ligjor të KPK-së për të hapur hetimin, në të cilin nuk u bënë akuza ose konstatime të shkeljeve disiplinore të kërkueses dhe detyrës së tij për të marrë një vendim në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të kërkueses. Një rregullim i tillë procedural nuk është i pazakontë në proceset disiplinore apo procese të tjera administrative në sistemet ligjore evropiane. Sipas këndvështrimit të gjykatës, vetëm fakti i thjeshtë që KPK-ja konstatoi gjetje paraprake në çështjen e kërkueses, nuk është i mjaftueshëm për të nxitur ndonjë frikë të justifikuar objektivisht në lidhje me paanësinë e KPK-së dhe detyrës së tij për të marrë një vendim në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të kërkueses. Një rregullim i tillë procedural nuk është i pazakontë në proceset disiplinore apo procese të tjera administrative në sistemet ligjore evropiane. Sipas këndvështrimit të gjykatës, vetëm fakti i thjeshtë që KPK-ja konstatoi gjetje paraprake në çështjen e kërkueses, nuk është i mjaftueshëm për të nxitur ndonjë frikë të justifikuar objektivisht në lidhje me paanësinë e KPK-së [...].

12.3. Sa i përket pretendimeve për përbërjen, mënyrën e emërimit dhe kohëzgjatjen e mandatit të Komisionit, sërish trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje vendimin e GjEDNj-së në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë* dhe jurisprudencën e Kolegjit në interpretim të dispozitave ligjore që rregullojnë kriteret dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit. Konkretisht, në paragrafët 300, 288 dhe 282 të vendimit, GjEDNj-ja arsyeton:

[...] Sipas këndvështrimit të gjykatës, fakti që anëtarët e KPK-së nuk vinin nga radhët e gjyqtarëve profesionistë në detyrë, ishte në përputhje me frymën dhe qëllimin e procesit të rivlerësimit, domethënë për të shmangur çdo konflikt individual interesi dhe për të siguruar besimin e publikut në këtë proces [...].

[...] Gjykata arrin në përfundimin se, duke pasur parasysh faktin, se si KPK-ja, ashtu dhe KPA-ja ishin krijuar dhe formuar në një mënyrë legjitime, duke përmbushur kërkesat e një “gjykate të krijuar me ligj”, kërkuesja i ishte adresuar gjykatës, sipas kuptimit të kushtit të parë të testit Vilho Eskelinen. Për këtë arsye, neni 6/1 i Konventës gjen zbatim nën aspektin civil të saj [...].

[...] Gjykata, më tej, përsërit se një organ, i cili nuk është klasifikuar si një nga gjykatat e vendit, për qëllimet e nenit 6/1, mund të klasifikohet brenda konceptit të një gjykate, në kuptimin material të kësaj shprehjeje. Sipas praktikës gjyqësore të vendosur të gjykatës, një ‘gjykatë’ karakterizohet në atë kuptim thelbësor të termit nga funksioni i saj gjyqësor, që do të thotë, të vendosë për çështjet brenda kompetencës së saj në bazë të rregullimeve ligjore dhe pas procedurave të zhvilluara në një mënyrë të përcaktuar. Ajo, gjithashtu, duhet të përmbushë një sërë kushtesh të mëtejshme, të tilla si pavarësia, në veçanti nga pushteti ekzekutiv, paanësia, kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të saj [...] (shih Guðmundur Andri Ástráðsson, cituar më lart, paragrafi 219, dhe referenca cituar aty) [...].

13. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në seancë relatori ka parashtruar të njëjtat konstatime të dërguara me raportin për rezultatet e hetimit, ndërkohë, lidhur me provat e depozituara pas njohjes me raportin, argumentet e tij në parashtrimet me shkrim, si dhe gjatë seancës, nuk u morën parasysh, duke u anashkaluar me një arsyetim të përciptë dhe jobindës.

13.1. Referuar akteve në fashikuj dhe procesverbalit të mbledhjes të datës 22.02.2021, konstatohet se trupi gjykues është njohur paraprakisht me shpjegimet dhe provat e paraqitura

⁷ Shih vendimin e GjEDNj-së, *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, paragrafët 307 dhe 308.

prej subjektit në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, ka dëgjuar relatimin e relatorit të çështjes lidhur me to dhe nuk ka pasur komente apo sugjerime të mëtejshme. Provat e paraqitura prej subjektit, shpjegimet e tij në parashtrimet për rezultatet e hetimit administrativ kryesisht dhe në seancë dëgjimore, janë vlerësuar prej Komisionit në vendimin objekt shqyrtimi, në përputhje me përcaktimet e nenit 57, pika 4, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Në përmbajtje të vendimit, rezulton se në pikën 22 të tij, Komisioni shprehet se ka marrë në analizë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, si ato me shkrim, ashtu edhe ato në seancë dëgjimore. Gjithashtu, në vendimin objekt shqyrtimi, për çdo pasuri të analizuar, janë pasqyruar shpjegimet dhe provat e paraqitura prej subjektit gjatë hetimit administrativ dhe në përgjigje të barrës së provës. Fakti që Komisioni nuk ka mbajtur qëndrim të njëjtë me sa pretenduar prej subjektit, dhe nuk ka vlerësuar shpjegimet dhe provat e paraqitura sipas vlerësimit të subjektit, nuk përbën shkak për të pretenduar *a priori* se janë anashkaluar provat dhe shpjegimet e subjektit e, aq më pak, me arsyetim të përciptë dhe jobindës. Komisioni, duke analizuar e vlerësuar çdo provë veçmas e të gjitha së bashku dhe çmuar sipas bindjes së brendshme se cilat fakte konsiderohen të provuara, ka ushtruar kompetencat e tij në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit nr. 84/2016.

14. Lidhur me pretendimin se mosaplikimi i parimit kushtetues të dyfishit të pasurisë së ligjshme cenon parimin e sigurisë juridike, Kolegji ka një jurisprudencë të konsoliduar⁸, nëpërmjet së cilës ka shtjelluar rëndësinë që kanë saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe shpjegimi bindshëm i burimit të ligjshëm të pasurisë për kontrollin e plotë dhe vlerësimin e kriterit të pasurisë, në plotësimin e kërkesave të normave kushtetuese dhe ligjore për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Në analizë të interpretimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka vlerësuar që secili prej paragrafëve të këtij neni normon një situatë të caktuar gjatë procesit të rivlerësimit të subjekteve, me elementë specifike dhe të pavarur, të cilët zbërthehen në përcaktimin e masave disiplinore, sipas pikave 1 dhe 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Ndër to, respektivisht, i pari lidhet me dyfishin e pasurisë së ligjshme, ndërsa tjetri me pamjaftueshmërinë e deklaramit të pasurisë. Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se mosaplikimi i parimit kushtetues të dyfishit të pasurisë së ligjshme cenon parimin e sigurisë juridike është i pabazuar në ligj.
15. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se është shkelur parimi i barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit duke e trajtuar atë në mënyrë të diferencuar nga subjekte të tjerë, për të cilët është vendosur konfirmimi në detyrë për situata të njëjta apo të ngjashme objektive. Duke theksuar se mbajtja e standardeve të njëjta të gjyqimit përfaqëson në thelb mbrojtjen e parimit të sigurisë juridike, subjekti pretendoi se standardet e shumëfishta të Komisionit për subjekte të ndryshme nxjerrin si konkluzion subjektivizmin e vlerësimit të provave.

15.1. Në shkaqet e ankimit për themelin, subjekti i rivlerësimit, duke cituar arsyetimin e Komisionit në disa vendime të tij për subjekte të tjerë rivlerësimi⁹, pretendon se në rastin e tij

⁸ Shih, ndër të tjerë, vendime të Kolegjit nr. 7/2019 (JR); nr.19/2019(JR); nr. 13/2020 (JR); nr. 25/2021 (JR); nr. 34/2021 dhe nr. 19/2022 (JR).

⁹ Në shkaqet e ankimit për themelin, subjekti referon vendimet e Komisionit: (i) nr. 352, datë 01.03.2021, ku është pranuar shpjegimi i subjektit të rivlerësimit I. B., lidhur me mospërputhjen në kohë, diferencën 44 ditë, të shumës

Komisioni ka mbajtur qëndrim të ndryshëm duke vlerësuar se *shuma e kredisë bankare të përfitur në vitin 2004 nuk provohet të jetë përdorur për efekt të pagimit të çmimit të pasurisë apartament, krijuar po këtë vit, për shkak se kontrata e kredisë bankare mban një datë të mëvonshme nga kontrata e shitjes së pasurisë. Në konsideratë të qëndrimit të Gjykatës Kushtetuese, [...] Barazia në ligj dhe para ligjit nuk duhet kuptuar se për çështje gjyqësore të pretenduara identike, të ketë zgjidhje të njëjlojta nga gjykatat. Mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, sepse çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, e harmonizuar me rrethana, faktorë, motive apo prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë absolutisht të njëjlojta. [...] Barazia në ligj dhe para ligjit nuk ka të bëjë me mënyrën se si është zgjidhur çështja në themel, por me garancitë ligjore, me të drejtat që shteti ka vënë në dispozicion të qytetarëve të tij për zgjidhjen e problemeve të tyre [...] ¹⁰, trupi gjykues sjell në vëmendje se referimi në vendime të tjerë të Komisionit nuk mund të përbëjë a priori shkak për të pretenduar për trajtim në mënyrë të diferencuar dhe për të konsideruar të padrejtë vendimin objekt shqyrtimi. Në të njëjtën linjë, GjEDNj-ja, në vështrim të standardeve të nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ka theksuar se dallimi në trajtim do të konsiderohet diskriminues, kur ai nuk ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, kur nuk ndjek një qëllim të ligjshëm ose kur nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme dhe përpjesëtimore ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet ¹¹. Në kushtet kur Komisioni, në bazë të provave të administruara, ka konstatuar probleme në vlerësimin e kriterit të pasurisë, të klasifikuara sipas parashikimeve të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pretendimet për vendosje të subjektit në pozita diskriminuese duken të tejkaluara. Trupi gjykues i Kolegjit, referuar juridiksionit dhe kompetencës së tij përcaktuar nga Kushtetuta ¹², vlerëson se, edhe në rastet që në pamje të parë duken të krahasueshme ose të ngjashme në lidhje me rrethanat e faktet e paraqitura, Kolegjit nuk mund t'i atribuohet roli për të krahasuar vendime të Komisionit, dhënë për subjekte rivlerësimi të ndryshëm. Kontrolli i vendimeve të Komisionit nga Kolegji kryhet vetëm nëpërmjet ankimit të subjekteve të rivlerësimit, në mënyrë individuale, sipas shkaqeve të ankimit, bazuar në rrethanat faktike të provuara gjatë hetimit administrativ dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni ¹³.*

16. Subjekti i rivlerësimit pretendon se është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, sipas tij analiza e pasurisë është rezultat i gjykimit të njëanshëm, duke u mbështetur vetëm në provat e mbledhura prej Komisionit, pa analizuar dhe shqyrtuar fare provat e paraqitura prej tij.

*së përfitur nga shitja e pjesës takuese të një pasurie të paluajtshme nga përfitimi i saj faktik; (ii) nr. {***}, datë 05.03.2021, ku është pranuar shpjegimi i subjektit të rivlerësimit L. R., lidhur me mospërputhjen në kohë ndërmjet pagimit të një pjese të çmimit të pasurisë dhe mënyrës së pasqyrimit të shlyerjes së saj në kontratën e shitjes.*

¹⁰ Shih vendimin nr. 71, datë 02.12.1998, të Gjykatës Kushtetuese.

¹¹ Shih vendimin e GjEDNj-së, çështja Karsën dhe të tjerë kundër MB.

¹² Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës përcakton se: "5. Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese [...]".

¹³ Shih vendime të Kolegjit, nr. 20/2021 (JR); nr.19/2022 (JR) dhe nr. 16/2022 (JR).

16.1. Në vendimin objekt shqyrtimi, në të kundërt nga sa pretenduar prej subjektit të rivlerësimit, rezulton se Komisioni, sipas shpjegimeve të dhëna nga subjekti në përgjigje të barrës së provës, nuk ka konsideruar si shpenzim shtesë të vitit 2004 kredinë e marrë në “Alpha Bank”, deklaruar si burim krijimi i pasurisë apartament të krijuar po këtë vit dhe nuk ka llogaritur si shpenzim vjetor të këtij viti vlerën e overdraftit. Gjithashtu, në vlerësim të provave të paraqitura prej subjektit, Komisioni ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat e bashkëshortes së subjektit dhe nënës së saj, të ndjerës F. G., të vërtetuara nga dokumentacioni përkatës. Lidhur me të ardhurat nga puna në emigracion të nënës dhe vëllait, subjekti ka paraqitur si prova kopje të pasaportave dhe lejeve të qëndrimit të tyre në Greqi. Komisioni i ka analizuar këto prova dhe ka vlerësuar se përmes tyre subjekti nuk arriti të ardhurat e personave të lidhur nga puna në emigracion, burimin e ligjshëm të tyre, si dhe krijimin e kursimeve. Gjithashtu, sipas jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit, Komisioni ka analizuar dhe vlerësuar për zbehjen e forcës provuese të deklaratës noteriale të administratores së firmës ndërtuese, znj. L. Q., hartuar gjatë procesit të rivlerësimit dhe për qëllim të këtij procesi. Nga sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konkludon se Komisioni ka kryer procesin e shqyrtimit dhe të vlerësimit të provave, në të gjitha fazat e procesit të rivlerësimit, dhe është shprehur për to në vendimin përfundimtar. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se analiza e pasurisë është rezultat i gjykimit të njëanshëm, duke u mbështetur vetëm në provat e mbledhura prej Komisionit, pa analizuar dhe shqyrtuar fare provat e paraqitura prej tij, është i pabazuar.

17. Subjekti pretendoi se analiza financiare e vënë në dispozicion gjatë hetimit administrativ, po ashtu edhe në vendimin përfundimtar, paraqet përfundimet e arritura, por jo metodologjinë, arsyet dhe mënyrën e përlllogaritjes së shpenzimeve, për të cilat objektivisht nuk ka pasur asnjë mundësi për të verifikuar saktësinë e përlllogaritjes.

17.1. Nga analiza e akteve në fashikujt e Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ndryshe nga sa pretendon subjekti, në raportin për rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit, metodologjia e përdorur për hartimin e analizës financiare është shtjelluar si seksion më vete në faqet 20-21 të tij. Në të pasqyrohet se Komisioni, për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës, është bazuar në shpenzimet mujore për konsum, sipas madhësisë së familjes (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT) dhe shkresën e ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 04.03.2019, të administruar në dosjen e subjektit. Për llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit në raport është sqaruar se Komisioni i është referuar vendimit nr. 11/2019 (JR), të Kolegjit. Gjithashtu, në raport janë pasqyruar të grupuara të ardhurat e konsideruara të ligjshme e të marra në konsideratë, si dhe të ardhurat që nuk janë marrë në konsideratë dhe arsyet përkatëse. Sa më sipër, me raportin për rezultatet e hetimit administrativ, subjektit i është bërë me dije, në mënyrë të detajuar, metodologjia e hartimit të analizës financiare.

17.2. Në datën 10.02.2021, përmes postës elektronike, subjekti ka paraqitur kërkesë për shtyrjen e afatit të depozitimit të parashtrimeve për rezultatet e hetimit administrativ, kërkesë e pranuar nga Komisioni, i cili ka njoftuar datën tjetër të caktuar më 19.02.2021. Si arsye për këtë kërkesë, subjekti ka parashtruar: (i) në dokumentacionin vënë në dispozicion mungon raporti i ILDKPKI-së, duke kërkuar t'i vihet në dispozicion ky akt; (ii) t'i vihen në dispozicion vendimet gjyqësore për të cilat janë bërë denoncime, për shkak të vështirësive të kërkimit të tyre në dosjet gjyqësore; (iii) analiza financiare përmban të dhëna vetëm në shifra, pa detajuar arsyet e arritjes në konkluzionet përkatëse, dhe metodologjinë për arritjen e tyre, është i

detyruar të konsultojë përmbajtjen e saj më një specialist të fushës së ekonomisë/kontabilitetit dhe eventualisht paraqitjen e kontestimeve lidhur me të. Ka qenë detyrim i ekspertëve të ngarkuar për hartimin e saj, paraqitja e një raporti të hollësishëm lidhur me të, duke evidentuar të gjithë metodologjinë, konkretizuar zërat e shpenzimeve dhe masën e tyre, pa më lënë barrën e hamendjesimit të arsyeve që kanë çuar në arritjen e përfundimeve përkatëse, çka në thelb ka cenuar të drejtën për një mbrojtje efektive, në kushtet e mungesës së arsytimit të raportit financiar, çka dikton nevojën e lënies së një afati të arsyeshëm për përgatitjen e kontestimeve lidhur me të ; (iv) ka pasur fatkeqësi familjare (vdekja e nënës së bashkëshortes) dhe se nëna e tij është e karantinuar për shkak të prekjës nga virusi Covid 19, situatë që e ka penguar për përgatitjen dhe paraqitjen e parashtrimeve brenda datës 12.02.2021.

17.3. Referuar kërkesës si më lartcitur, konstatohet se ka qenë zgjedhje e subjektit për t'u konsultuar me specialistë të jashtëm lidhur me analizën financiare, për sa prej tij nuk është kërkuar asnjë sqarim nga Komisioni në këtë drejtim. Sikundër u analizua më lart, në raportin për rezultatet e hetimit administrativ, janë dhënë sqarime të hollësishme për metodologjinë e hartimit të analizës financiare dhe në parashtrimet me shkrim subjekti shprehet se [...] *e gjithë metodologjia e përdorur nga Komisioni bazohet në thelb në këto konkluzione [...]*, duke renditur si të tilla moskonsiderimin e: (i) të ardhurave nga emigracioni të personave të lidhur, nënës dhe vëllait; (ii) përdorimit të shumës së kredisë të përfituar në vitin 2004 si burim për krijimin e pasurisë apartament po këtë vit; (iii) mundësive financiare të personave të tjerë të lidhur, familjarëve të bashkëshortes, për të dhuruar, në formën e prikës, shumën prej 1.000.000 lekësh në vitin 2010. Këto çështje gjejnë trajtim të hollësishëm në raportin për rezultatet e hetimit administrativ, si në analizën e pasurive nën hetim, ashtu edhe në metodologjinë e analizës financiare, pjesë e raportit, për rrjedhojë nuk ka shkak për të pretenduar për mungesë qartësie sa i përket metodologjisë së përdorur për hartimin e analizës financiare. Konstatohet se në parashtrimet për rezultatin e hetimit administrativ, subjekti nuk ngre pretendime për mënyrën e llogaritjes së shpenzimeve të jetesës së tij dhe të familjes, ndërsa në ankim pretendon kryesisht për dublim të tyre për periudhat që ka qenë te të afërmit në Greqi apo për rastet e udhëtimeve për qëllime pune që janë trajtuar me dietë. Për rrjedhojë, duket që subjekti synon të potencojë pretendimet lidhur me shkelje të kryera prej Komisionit, sesa të paraqesë një pretendim real për zbatim të gabuar të rregullimeve ligjore, konsideruar se në vendimin objekt shqyrtimi, në metodologjinë për analizën financiare, pasqyrohet se *në rastet kur qëndrimi është deklaruar dhe vërtetuar me dokumentacion shkresor të familjarët e subjektit/bashkëshortes, nuk janë llogaritur shpenzime qëndrimi*. Së fundmi, siç rezulton nga procesverbalet në fashikullin e Komisionit, subjekti ka pasur mundësinë gjatë seancës dëgjimore dhe është shprehur lidhur me gjetjet e Komisionit, sikurse edhe ka paraqitur provat që ka konsideruar të nevojshme për mbrojtjen e tij. Gjithashtu, në vendimin e Komisionit, analiza financiare për periudhën 2003-2016 dhe metodologjia e përdorur janë pasqyruar si pjesë më vete, në faqet 21-23 dhe, po ashtu, janë pasqyruar edhe analiza të pjesshme në funksion të mundësive financiare të subjektit për blerjen e pasurisë apartament në vitin 2004, si dhe të mundësive të familjes së bashkëshortes së subjektit për dhurimin në formën e prikës të shumës prej 1.000.000 lekësh në vitin 2010. Konstatohet se të dhënat e hollësishme në vendim lidhur me metodologjinë i kanë dhënë mundësinë subjektit të kundërshtojnë në Kolegj analizën financiare të hartuar nga Komisioni. Nga sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konkludon se pretendimi i

subjektit se objektivisht e ka pasur të pamundur të verifikojë mënyrën e përlogaritjes së shpenzimeve të jetesës është i pabazuar.

18. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se vendimi i marrë nga Komisioni është rezultat i një procesi të paragjykuar, për të cilin parashtrori sa më sipëranalizuar. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe në këtë këndvështrim pretendimet e subjektit rezultojnë të pabazuara në akte dhe në ligj. Në kushtet kur subjekti pretendon paragjykim, por ka dështuar të argumentojë se cila sjellje, procedurë apo përfundim i Komisionit përbën paragjykim dhe mbi çfarë baze apo arsyesh ka ndodhur, pretendimi, përpos i pakuptimtë, vlerësohet nga trupi gjykues i Kolegjit i pabazuar.
19. Në përmbledhje të gjithë argumenteve të shtjelluara më sipër, në konsideratë edhe të qëndrimeve të Gjykatës Kushtetuese në jurisprudencën e saj¹⁴, si dhe të GjEDNj-së¹⁵, lidhur me parimet e procesit të rregullt ligjor, gjykimin kontradiktor dhe barazinë e armëve, për rëndësinë e krijimit të mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve në proces, përmes mundësive për të paraqitur provat dhe vlerësimet ligjore të lidhura me çështjen që shqyrtohet, trupi gjykues i Kolegjit konstaton që pretendimet e subjektit se Komisioni ka cenuar parimet e procesit të rregullt nuk qëndrojnë. Për sa është arsyetuar gjerësisht më sipër, këto pretendime rezultojnë të pambështetura në ligj, në aktet në fashikull dhe subjektit të rivlerësimit i janë krijuar mundësitë të ushtrijë të gjithë të drejtat e tij për proces të rregullt. Po ashtu, interpretimi i Kushtetutës dhe ligjit nga Komisioni, për gjithë aspektet e sipëranalizuara, rezulton i drejtë.

C. Mbi shkaqet e ankimit për vlerësimin e pasurisë

C/I Pasuria apartament me sipërfaqe 85 m², ndodhur në qytetin e Korçës, blerë në vitin 2004, në vlerën 2.900.000 lekë, pjesë takuese 100%

20. Për këtë pasuri, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, sipas përcaktimeve të germës "b", të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka vlerësuar si vijon.
 - Subjekti nuk arriti të provojë se kredia e përfituar prej 15.000 eurosh është përdorur si burim për blerjen e kësaj pasurie dhe nuk u vërtetua nga subjekti me prova shpresore qëllimi i marrjes e destinacioni i saj, si dhe nuk u provua kalimi i kësaj shume te pala shitëse.
 - Shpjegimet e subjektit për praktikatat e bankës mbeten vetëm në kuadër deklarativ dhe nuk u mbështetën në ndonjë provë konkrete. Kodi Civil, por dhe praktika e bankave, në raste të tilla përcakton edhe forma të tjera kontratash, duke përfshirë bankat si pjesë e kontratës së shitblerjes, përderisa banka është financuese e kredisë së përfituar, sipas qëllimit dhe destinacionit të kredisë.
 - Në kontratën e shitblerjes së pasurisë nr. {***}, datë 04.06.2004, lidhur para noterit, palët kanë shprehur vullnetin e tyre të pavesuar se janë likuiduar midis tyre jashtë zyrës noteriale. Pasuria apartament është regjistruar në ZVRPP-në Korçë në emër të subjektit disa muaj përpara marrjes së kredisë prej 15.000 eurosh, duke përbushur qëllimin për të cilën është lidhur kontrata.

¹⁴ Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese, ndër të tjerë, nr. 21/2015, nr. 34/2015 dhe nr. 37/2016.

¹⁵ Shih vendimet e GjEDNj-së, ndër të tjerë, Ruiz-Mateos kundër Spanjës; McMichael kundër Mbretërisë së Bashkuar; Vermeulen kundër Belgjikës; Lobo Machado kundër Portugalisë; Kress kundër Francës.

- Deklarata noteriale me nr. {***}, datë 07.12.2020, e lëshuar nga pala shitëse L.Q., ku pasqyrohet mënyra e përfitimit të çmimit dhe fakti që për pagimin e tij është përdorur kredia e përfituar nga kontrata e kredisë, datë 25.10.2004, nuk u mor në konsideratë, për arsye se pala shitëse nuk ka qenë e përfshirë në procedurat e marrjes së kredisë dhe nuk mund ta konfirmojë këtë fakt, kjo dhe në referim të nenit 232 të K.Pr.Civile.
- Subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të pretenduar si e ardhur nga nëna e tij në vlerën prej 700.000 lekësh dhe prej 1.200 eurosh.

20.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton vendimin e Komisionit, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur sa vijon.

- i) Konkluzioni i Komisionit, për mosnjohjen e shumës së kredisë prej 15.000 eurosh si burim i ligjshëm për blerjen e pasurisë, është i pabazuar në kushtet e mungesës së çfarëdo indicie mbi ndonjë qëllim të ndryshëm të marrjes apo përdorimit të kredisë apo kryerjes së ndonjë veprimi me qëllim fshehjen e fakteve apo rrethanave lidhur me deklarin e pasurisë. Komisioni ka përqendruar arsyetimin vetëm në faktin që kontrata e kredisë mban një datë të mëvonshme nga kontrata e shitblerjes, pa u thelluar në faktin se ato mbeten në kuadër të pasaktësive, plotësisht të justifikueshme nën dritën e zbatimit të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit.
- ii) Referuar tërësisë së akteve dhe argumenteve, nga pikëpamja ligjore dhe logjike, nuk ka vend për mënyrë tjetër interpretimi, përpos deklarimit të saktë të pasurisë dhe justifikimit të saj me burime të ligjshme. Aktet e kredisë, datë 25.10.2004, dhe argumentet e tij, janë arsye që çojnë në përfundimin që kredia është miratuar vetëm për qëllimin e blerjes së një pasurie të paluajtshme. Kontrata e kredisë:
 - është siguruar me hipotekë, sipas kontratës me nr. {***}, datë 25.10.2004, duke lënë si garanci pikërisht këtë apartament, duke provuar lidhjen e drejtpërdrejtë të kredisë së marrë dhe qëllimit të saj;
 - është hartuar kur kredidhënia për qëllime banimi ka qenë në faza embrionale, mangësitë dhe të metat e konstatuara me të drejtë nga Komisioni mbështesin argumentin se nuk mund të gjykohet me standardet aktuale dhe nuk ka arsye të penalizohet për faktin se banka nuk ka evidentuar si rubrikë të veçantë dhe pjesë përbërëse të kontratës së kredisë qëllimin e dhënies së saj.
- iii) Për shprehjen në kontratën e shitjes *çmimi i shitjes është paguar jashtë zyrës noteriale*, shprehje klishe e përdorur nga të gjithë noterët e kohës, prej tij janë dhënë shpjegime të hollësishme pse ky pasqyrim bien ndesh me realitetin. Kjo shprehje duhet të vlerësohet vetëm si pasaktësi, pasi ka provuar se në kushtet e mirëbesimit, për shkak të njohjes së vjetër të nënës së tij me shtetasen L. Q. [*një prej pronarëve të pasurisë, që ka përfaqësuar me prokurë dhe pronarët e tjerë*], është rënë dakord për përpilimin e kontratës së shitjes, por me kushtin e shprehur *verbal për pagimin e diferencës së çmimit pas marrjes së kredisë*. I njëjti pasqyrim është edhe në kontratën e shitjes së pasurisë tjetër, apartament me sipërfaqe 111,51 m², në Korçë, ku sërish kredia është përfituar në një kohë të mëvonshme, pa u gjetur si shkelje prej Komisionit, konstatim i mjaftueshëm për të shuar të gjithë dyshimet lidhur me destinimin e shumës së kredisë edhe në rastin e kësaj pasurie.

iv) Dokumentacioni zyrtar për të ardhurat e familjarëve nga puna në emigracion, nga viti 1992, është objektivisht i pamundur për t'u siguruar. Të paktën deri në vitin 2000, me daljen e kuadrit ligjor për rregullimin e statusit të emigrantëve në Greqi, kategoritë e punëve të lidhura kryesisht me pastrimin apo përkujdesjen ndaj të moshuarve nuk janë formalizuar me kontrata pune apo deklaram të punëdhënësit pranë organeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore. Në një interpretim të kujdesshëm të statusit të nënës, kryefamiljare me dy fëmijë të mitur, shkurtimin e vendit të saj të punës në Shqipëri në vitin 1991, nën frymën dhe qëllimin e ligjit nr. 84/2016, nuk ka asnjë dyshim lidhur me të ardhurat e siguruara nga puna në emigracion në Greqi, por edhe ligjshmërinë e tyre në kuptim thelbësor. Në vitet 1992-2005, familja nuk është gjendur në kushtet komode për të plotësuar kërkesat e sotme të sigurimit të legjislacionit në punë, për faktin se kjo ka qenë e pamundur. Për këto arsye, është joproporcionale dhe në kundërshtim me frymën e ligjit konkluzioni për mosprovimin e të ardhurave të familjarëve të tij nga emigracioni, kryesisht të nënës, të cilat efektivisht janë realizuar.

20.2. Për sa i përket mënyrës së deklaramit të kësaj pasurie, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në deklaramtën e pasurisë *vetting* rezulton e deklaramuar *apartament banimi, me nr. pasurie {***}, Korçë, me sip. 85 m², burimi, kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.06.2004. Fitimi i pronësisë u realizua pas shlyerjes së plotë të kredisë me kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.10.2004, në vitin 2014, me kreditor Alpha Bank, Tiranë për shumën 15.000 euro, afati 10 vjet dhe çlirimit të pronës nga hipoteka të bllokuar në favor të Alpha Bank. **Burimi i krijimit:** shuma 15.000 euro e marrë nga kontrata e kredisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.10.2004. Shlyer në vitin 2014, shlyer gjithsej 21.831 euro. Pagar nga nëna - 700.000 lekë. Burimi i të ardhurave të nënës - të ardhura nga emigracioni në vitet 1992 -2005. Puna ka qenë e pasiguruar, prandaj nuk mund të sigurohet dokumentacioni ligjor lidhur më të ardhurat e realizuara ndër vite prej saj. **Vlera:** 2.900.000 lekë, pjesë takuese: 100%.*

20.3. Kolegji, pasi shqyrtoi vendimin e Komisionit dhe aktet në fashikuj, brenda kufijve të shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit, lidhur me pasurinë apartament me sipërfaqe 85 m² të ndodhur në Korçë, vlerëson se pretendimet e subjektit janë të pabazuara në ligj e në prova. Në vijim, arsyetimi i trupit gjykues të Kolegjit shtjelluar në detaj.

20.4. Në kontratën e shitblerjes nr. {***}, datë 04.06.2004, të pasurisë apartament me sip. 85 m², me nr. pasurie{***}, {***}, Korçë, pasqyrohet se *shitësit¹⁶ deklarojnë se apartamentin në pronësi të tyre ia shesin blerësit kundrejt çmimit prej 2.900.000 lekësh, të cilën e kanë marrë plotësisht jashtë kësaj zyre dhe blerësi deklaroi se është dakord me blerjen e apartamentit kundrejt çmimit prej 2.900.000 lekësh, shumë të cilën e ka dorëzuar plotësisht dhe jashtë kësaj zyre.* Subjekti i rivlerësimit e ka regjistruar titullin e pronësisë në ZVRPP-në Korçë më datë 15.06.2004. Në këtë situatë faktike, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kontrata e shitblerjes, me forcën e ligjit për palët në kuptim të nenit 690 të Kodit Civil¹⁷, përbën provë të plotë të deklarimeve të pavesuara dhe të ligjshme të palëve përpara noterit, në kuptim të nenit 253 të

¹⁶ Shitësit L. Q., Zh. D., I. B., F. K. dhe R. T., janë përfaqësuar nga L. Q. në bazë të prokurës së posaçme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.02.2004.

¹⁷ Kodi Civil në nenin 690 parashikon: "Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj".

Kodit të Procedurës Civile¹⁸. Me nënshkrimin e kontratës së shitjes, me efekt provueshmërie *ad probationem*, palët kanë marrë garancitë për përmbushjen e detyrimeve, të cilat nuk mund t'i siguronin vetëm në bazë mirëbesimi, sendi është transferuar te blerësi, pasi prej tij është përmbushur detyrimi për të paguar çmimin e shitjes përpara nënshkrimit të kontratës. Duke analizuar *a contrario*, sikundër pretendon subjekti për *marrëveshje verbale në mirëbesim për shkak të njohjeve të vjetra të nënës së tij me përfaqësuesen e shitësve, L. Q.*, më së paku palët do të kishin formalizuar këtë marrëveshje, qoftë edhe me një shkresë të thjeshtë nënshkruar prej tyre, në konsideratë të faktit se për katër shitësit e tjerë, bashkëpronarë të pasurisë, nuk pretendohet të ishin në dijeni për këtë sjellje të përfaqësueses së tyre dhe blerësit. Nga ana tjetër, si për L. Q. edhe për shitësit e tjerë, shlyerja e çmimit të pasurisë me kredi bankare mbarte paqartësi nëse kredia do të përfitohej nga blerësi, nëse shuma e saj do të ishte e mjaftueshme për shlyerjen e çmimit të pasurisë, si dhe për kohën kur kredia mund të miratohej dhe disbursohet, për sa këto nuk pasqyroheshin në kontratën e shitjes. Edhe për shkak të këtyre pasigurive, nuk mund të pretendohet se me një marrëveshje verbale shitësit kishin marrë garanci të mjaftueshme për të nënshkruar aktin e shitblerjes e për t'u zhveshur nga e drejta e pronësisë, për sa mbetej për t'u shlyer më shumë se gjysma e çmimit të shitjes së pasurisë.

20.5. Subjekti pretendoi se deklarata noteriale nr. {***}, datë 07.12.2020, e shtetas L. Q., administratore e shoqërisë, ku pasqyrohet hollësisht mënyra e përfitimit të çmimit të apartamentit dhe pagimi i tij, nuk është marrë në konsideratë nga Komisioni *me qëllimin e vetëm për rrëzimin e deklarimit nën përgjegjësi të administratorës së firmës*, duke referuar në mënyrë të pabazuar nenin 232 të K.Pr.Civile, dispozitë që rregullon një aspekt të vlerësimit të provave të procesin civil, lidhur me kufijtë e provës me dëshmitarë, ndërkohë që procesi i rivlerësimit është me natyrë të ndryshme dhe me hapësira e mjete provuese të pakufizuara. Trupi gjykues, duke risjellë në vëmendje qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit, lidhur me vlerën provuese të kufizuar të deklaratës noteriale bërë gjatë procesit të rivlerësimit, në mbështetje të pretendimeve të subjekteve të rivlerësimit, konstaton se deklaruesja nuk shprehet se shitësit e pasurisë të jenë ndikuar nga një *nevojë e madhe e blerësit/subjektit*, sikundër deklaroi subjekti në parashtrimet për rezultatet e hetimit *situata dhe nevoja për strehim e familjes ka qenë emergjente, në kushtet kur banesa në të cilën kemi jetuar, në cilësinë e qiramarrësit qysh në vitet '70 (ndoshta më herët) ka qenë në prag të rrënimit dhe jashtë çdo kushti minimal për të vijuar banimin*, megjithëse edhe sipas këtij pohimi të subjektit dhe të dhënave të sistemit TIMS¹⁹ konstatohet se dy anëtarët e tjerë të familjes, nëna dhe vëllai, prej vitesh në emigrim, kanë vijuar të jenë në kushte emigracioni edhe në periudhën 5-vjeçare pas blerjes së apartamentit, 2005-2010, gjatë së cilës në Shqipëri kanë jetuar përkohësisht me ndërprerje. Duke ju rikthyer deklaratës noteriale të L. Q., si arsye të dakordësimit të kushteve të shlyerjes së çmimit të pasurisë, deklarohet vetëm *besimi në korrektësinë e blerësit për shkak të njohjeve të vjetra me nënën e tij*. Në një situatë faktike, ku çmimi i shitjes pretendohej të sigurohej me

¹⁸ Kodi i Procedurës Civile në nenin 253 parashikon: "Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e aktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre".

¹⁹ Të dhënat nga sistemi TIMS, dërguar me shkresën nr. {***} prot., datë 04.03.2020, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, rezulton se shtetasja N. Xh. ka 4 hyrje në territorin shqiptar në vitin 2004, 9 hyrje në vitin 2005, 9 hyrje në vitin 2006; 5 hyrje në vitin 2007; 6 hyrje në vitin 2008; 6 hyrje në vitin 2009; dhe 3 hyrje në vitin 2010.

kredi bankare, vetëm korrektësia e blerësit, kur në këtë cilësi ishte djali dhe jo vetë nëna e tij, nuk do të ishte e mjaftueshme për të nxitur ndërmarrjen e veprimeve me risk financiar.

20.6. Lidhur me pretendimet se aktet e kredisë bankare të përfitur nga “Alpha Bank” dhe argumentet e tij janë arsye që çojnë në përfundimin se kredia është miratuar vetëm për qëllimin e blerjes së një pasurie të paluajtshme, trupi gjykues vlerëson si vijon.

Së pari, aktet e kredisë bankare, [kontratë kredie shërbyer me llogari rrjedhëse nr. {***}, datë 25.10.2004, shtesë e kontratës së kredisë së shërbyer me llogari rrjedhëse nr. {***}, datë 25.10.2004, marrëveshje shtesë financimi, kontratë hipoteke], janë hartuar përpara noterit në datën 25.10.2004, rreth 4.5 muaj pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së pasurisë dhe 4 muaj pas regjistrimit të titullit të pronësisë pranë ZVRPP-së, Korçë, në datën 15.06.2004. Për rrjedhojë, do të rezultonte që banka të ketë shqyrtuar aplikimin për kredi për blerje të një apartamenti duke administruar dokumentacion ligjor provues që aplikanti/subjekti gëzonte tagrat e pronësisë prej muajsh, situatë që bën të pabesueshme miratimin e kredisë me qëllim blerje të kësaj prone.

Së dyti, në kontratën e kredisë nuk përcaktohet qëllimi i marrjes së kredisë, ndërsa në marrëveshjen shtesë të financimit parashikohet se *huaja jepet me afat prej 10 vjetësh që fillon nga data e parë e disbursimit me shlyerje këste tremujore me qëllim të vetëm blerje apartamenti*. Në aktet e kredisë konstatohen parashikime që nuk kanë relevancë me pasurinë apartament, të hipotekuar për të garantuar shlyerjen e kredisë, me statusin e kredimarrësit/subjektit apo qëllime dhe veprimtari të mëpasshme të tij. Përcaktimi si detyrime të kredimarrësit i mbajtjes së librave kontabël apo veprime të tjera lidhur me ndërmarrje, makineri e pajisje, aktivitete të shoqërisë, mbi të cilat banka ka interesa dhe garanci reale, etj., njëherazi edhe si kushte, shkelja e të cilave përbën shkak për prishjen e marrëveshjes së kredisë, krijon bindjen që aktet priren të jenë “tip” për kredidhënie edhe në raste të tjera. Në këtë situatë faktike, kur me dokumentacionin e dorëzuar prej tij me deklaratën *vetting* qëllimi i kredisë mbetet i papërcaktuar, subjektit i ka kaluar barra e provës, ndër të tjera, se *nuk provon me veprime dhe dokumentacion ligjor për përdorimin e kredisë së marrë në tetor të vitit 2004*. Në përmbysje të barrës së provës, subjekti nuk ka kërkuar pranë bankës kopje të dokumentacionit fizik të dosjes së kredisë, i cili, sipas praktikave bankare të pandryshuara në kohë, përmban kërkesën e aplikantit ku pasqyrohet qëllimi për të cilin kërkohet kredia e, po ashtu, edhe akte të brendshme të bankës për shqyrtimin dhe miratimin e kredisë, sipas qëllimit të shprehur nga aplikanti. Në kushtet e formularëve “tip” të përdorur për formalizimin e kredisë, ky dokumentacion, që do të hidhte dritë mbi qëllimin e marrjes dhe përdorimit të kredisë bankare, nuk është referuar nga subjekti i rivlerësimit as në ankim. Për rrjedhojë, subjekti ka dështuar të provojë pretendimin se *nuk ka idicie për ndonjë qëllim tjetër të marrjes së kredisë apo përdorimit të saj apo kryerjen e ndonjë veprimi me qëllim fshehjen e fakteve apo rrethanave lidhur me deklarimin e pasurisë*.

Së treti, subjekti nuk e deklaroi kohën kur ka ndërmarrë veprime në bankë, lidhur me komunikime në funksion të përfitimit të kredisë apo kur ka paraqitur kërkesën e formalizuar me shkrim, për sa edhe me kontratën e shitjes, hartuar përpara noterit, vërtetohej pronësia e

sendit që do të shërbente si kolateral për kredinë²⁰ dhe me regjistrimin e titullit të pronësisë nuk kishte asnjë pengesë për të disponuar lirisht apartamentin. Fakti që kontrata e kredisë daton rreth 4.5 muaj nga ky moment nuk duket të dëshmojë për nxitim të subjektit për sigurimin sa më parë të shumës të kredisë, sipas pretendimit se çmimi i pasurisë pritej të shlyhej i plotë përmes saj. Në këtë situatë faktike, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar deklarin e subjektit se *diferenca kohore ndërmjet përpilimit të kontratës së shitjes dhe pagimit të diferencës së çmimit, ka ardhur për shkakun e vetëm, që lidhet me pamundësinë e përfitimit të kredisë, pa u regjistruar fillimisht prona në regjistrat hipotekore, në emrin tim.*

Së katërti, subjekti ka dështuar të provojë kalimin e shumës së kredisë prej 15.000 eurosh te shitësit. Shuma e kredisë është disbursuar në llogarinë bankare të subjektit në datën 04.11.2004 dhe është tërhequr *cash* prej tij në po këtë datë. Pretendimi i subjektit se dorëzimi i shumës te shitësit është bërë me mandatarkëtime, të cilat nuk i disponon për shkak të kohës së largët, mbetet deklarativ për sa edhe L. Q. në deklarin e saj nuk shprehet se për pjesën e mbetur pa shlyer të çmimit të shitjes derdhja e shumës është bërë kundrejt mandatarkëtimeve.

Së pesti, lidhur me pretendimin e subjektit se në rastin e pasurisë tjetër, *apartament me sipërfaqe 111,51 m², kredia është përfituar në një kohë të mëvonshme nga kontrata e shitblerjes, por këtë rast Komisioni nuk e ka gjetur shkelje - konstatim i mjaftueshëm për të shuar të gjithë dyshimet lidhur me destinimin e shumës së përfituar të kësaj kredie*, nga aktet në fashikuj, konstatohet se rrethanat faktike nuk janë të njëjta në të dy rastet. Konkretisht, për pasurinë apartament me sipërfaqe 111,51 m², në kontratën e shitblerjes përcaktohet se kësti i dytë do të paguhet me kredinë e marrë në BKT nga blerësi dhe në datën e disbursimit të kësaj kredie pothuaj e gjithë shuma ka kaluar me transfertë bankare në llogarinë e shitësit, të dhëna apo veprime të munguara në rastin e kredisë në vitin 2004. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se rasti i kredisë në vitin 2014, përfituar më vonë se kontrata e shitblerjes së pasurisë tjetër apartament, po në qytetin e Korçës, provon edhe sa i përket përdorimit të kredisë së përfituar në vitin 2004, vlerësohet prej trupit gjykues i pabazuar.

20.7. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se megjithëse shuma e kredisë, me të drejtë, është reflektuar në analizën financiare, çka çon në konkluzionin që është njohur si burim për krijimin e pasurisë, në vendim argumentohet që nuk provohet destinimi i saj për shlyerjen e kredisë. Duke mos u konsideruar *shpenzim shtesë* është përjashtuar përdorimi i kësaj shume për çfarëdolloj shpenzimi tjetër, duke mbetur logjikisht qëllimi i vetëm i saj *pagimi i një pjese të çmimit të apartamentit.*

20.7.1. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se edhe ky pretendim i subjektit është i pabazuar. Me dokumentacionin e administruar në fashikuj, provohet se subjekti i rivlerësimit ka përfituar kredinë prej 15.000 eurosh nga “Alpha Bank” ShA, disbursuar e plotë në llogarinë bankare të tij, për rrjedhojë kjo shumë është konsideruar si ardhur e subjektit. Shuma e kredisë është deklaruar në deklaratën *vetting* dhe deklaratën e pasurisë të vitit 2004, si burim krijimi i

²⁰ Referuar vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 01, datë 06.01.2009: “[...] Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme është i vlefshëm sepse i plotëson të gjitha kushtet e parashikuara në nenet 79, 663, 659 të Kodit Civil. Pronësia mbi një pasuri të paluajtshme kalon në çastin e lidhjes së kontratës së tjetërsimit të kësaj pasurie. Blerësi ose përfituesi i kësaj pasurie bëhet pronar i ligjshëm i saj që në momentin e nënshkrimit të kontratës duke fituar dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me të qenit pronar mbi këtë pasuri [...]”.

pasurisë, si dhe në deklaratat periodike vjetore të pasurisë, në formularin e detyrimeve. Fakti që subjekti ka dështuar të provojë se kjo shumë është përdorur për blerjen e apartamentit nuk përbën shkak për të pretenduar se përdorimi i saj për çdo qëllim tjetër është i përjashtuar. Argumenti i subjektit se edhe logjikisht përdorimi i shumës për dy muajt e mbetur të vitit ishte i pamundur, *a prima facie* duket bindës për sa nuk rezultojnë pasuri të krijuara prej tij gjatë kësaj periudhe e në fund të vitit 2004 nuk është deklaruar gjendje *cash*. Por në kontekst të kohës së kryerjes së deklaramit, kur ligji nr. 9049/2003, i sapo hyrë në fuqi, ende i pa konsoliduar me shtesat e ndryshimet në vitet e të mëvonshme, nuk përfshinte në detyrimin për deklarim të shpenzimeve të tjera, si p.sh. për mobilim etj., nuk mund të pretendohet se provohet mospërdorimi i saj për çdo qëllim tjetër. Në këtë kontekst, evidentohet se subjekti ka deklaruar se [...] *për arredimin e këtij apartamenti është përdorur/transferuar ai i shtëpisë së mëparshme (mobilet dhe pajisjet ekzistuese), investim i prindërve të tij, dhe pasurimi i mëtejshëm është bërë nga nëna me të ardhurat nga emigracioni [...]*,²¹ deklarim i cili duket të synojë “lehtësim” të analizës financiare nga ky zë shpenzimesh. Konsideruar se në shtëpinë me qira familja ka banuar nga vitet ‘70, realitetin e vendit përpara viteve ‘90, mundësitë e familjeve shqiptare për arredimin e banesave të tyre, si në aspektin financiar, ashtu edhe në mundësitë që ofronte tregu i kohës, pretendimi i subjektit *për përdorim/transferim të mobilimit dhe pajisjeve ekzistuese të shtëpisë në prag të rrënimit dhe jashtë çdo kushti minimal për të vijuar banimin*, situatë e pafavorshme për të investuar në mobilimin, duket jobindës pretendimi i subjektit për mungesë totale të shpenzimeve prej tij në këtë drejtim, sikundër deklaron në pyetësonin standard *në blerjen e apartamentit unë kam investuar vetëm vlerën e përfutur me kredi në shumën 15.000 euro (referuar deklarimeve periodike), ndërsa çdo shpenzim tjetër është mbuluar nga të ardhurat e siguruar nga nëna ime [...]*²². Për sa më sipër, përdorimi i shumës së kredisë për shpenzime të tjera nuk mund të pretendohet i përjashtuar.

20.8. Lidhur me pretendimet e subjektit për ligjshmërinë e të ardhurave të nënës nga emigracioni, deklaruar si burim krijimi i pasurisë, shuma prej 700.000 lekësh në vitin 2004 dhe shuma prej 1.200 eurosh për shlyerjen e kësteve të kredisë bankare në vitin 2007, për një vlerësim tërësor të situatës së tij faktike dhe familjare, në përputhje me parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson si vijon.

20.9. Referuar dokumentacionit të paraqitur prej subjektit: kopje të pasaportave të nënës, lëshuar nga autoritet e vendit në datën 27.12.1995 dhe në datën 06.11.2003; të “kartës speciale të identitetit”, lëshuar e para më 29.11.2002, e dyta më 26.01.2006 dhe e treta më 29.01.2015; si dhe të lejes së qëndrimit në shtetin grek lëshuar më 23.07.2019 - vajtja më e hershme e nënës në Greqi daton në vitin 1996. Megjithatë, deklarata e pasurisë e vitit 2003, ku subjekti deklaroi se *nëna dhe vëllai prej vitit 1992 dhe deri në këto momente banojnë në Greqi, të ardhurat e tyre për momentin janë rreth 1.500 euro/muaj*, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, nenit 32, pika 5, provon për kohën e emigrimit të familjarëve të subjektit në Greqi, të paktën para kësaj periudhe.

²¹ Përgjigja për pyetjen 11 të pyetësonit standard “Sa është vlera e arredimit të shtëpive tuaja”.

²² Subjekti, në pyetësonin e referuar, lidhur me vlerën e arredimit, gjithashtu, deklaroi se mund të shprehem që përafërsisht vlera e përgjithshme e arredimit të apartamentit me nr. pasurie {***} me sip. 85 m², mund të përlllogaritet në shumën 600.000 lekë. Për shkak të kohës së largët, ndryshimit të çmimeve, vlerës së mobileve në kohën e transferimit etj., nuk mund të jem i saktë dhe kjo vlerë i përgjigjet një përlllogaritjeje të përafërt nga ana ime. Sikurse e theksova më sipër, pjesa dërrmuese e tij përbëhet nga pajisjet e transferuara nga shtëpia ku kemi jetuar deri në vitin 2014. Mund të shtoj që vlera e shtuar e arredimit pas vitit 2004, mund të përlllogaritet në shumën 200.000-300.000 lekë.

20.10. Mbajtur në konsideratë vështirësitë e shtetasve shqiptarë që emigruan në Greqi pas vitit 1990, sa i përket rregullimit ligjor të marrëdhënieve të tyre të punësimit²³, e në këtë kontekst veçanërisht të shtetaseve shqiptare, për shkak të kategorive të punëve ku u angazhuan²⁴, për mundësitë financiare të familjarëve të subjektit për të krijuar kursime me të ardhura nga puna në emigracion e ligjshmërinë e tyre, trupi gjykues analizoi në vështrim të krahasuar deklaratat e pasurisë së subjektit me dokumentacionin e paraqitur si më sipërcituar. Në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, subjekti i deklaroi të ardhurat e familjarëve *për momentin*, pa përcaktuar ndarje mes të ardhurave të nënës dhe të vëllait. Ky deklaram, që përkon me periudhën pas pajisjes së nënës me *kartë speciale të identitetit* në datën 29.11.2002, dëshmon se të ardhurat e tyre mujore nuk kishin stabilitet, për rrjedhojë krijimi i kursimeve duket pothuaj i pamundur. Në këtë linjë arsyetimi shkon edhe fakti se subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument për të provuar krijimin e kursimeve, depozitimim e kursimeve në ndonjë bankë greke apo dërgimin si remitanca përmes transfertave bankare.

20.11. Përpos sa më sipër, në deklaratën e pasurisë të vitit 2004, në rubrikën “Të ardhurat”, subjekti deklaroi *ndihma e pjesëtarëve të familjes për blerje shtëpie (nga emigracioni), në vlerën 1.500.000 lekë*. Subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument për të provuar së paku të ardhurat e siguruar prej nënës nga viti 2002, kur pajiset nga shteti grek me dokumentin *kartë speciale identiteti*, por në përgjigje të barrës së provës ka deklaruar se *nuk disponon dokumentacion për të ardhurat e nënës nga emigracioni në Greqi nga viti 1992, pasi kanë punuar në kushtet e informalitetit*. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit për të zbatuar parimin e objektivitetit edhe për të ardhurat e periudhës pas vitit 2002, kur provohet se nëna e subjektit nuk ka pasur pengesa për formalizimin e marrëdhënieve të punës, për shkakun e parashtruar se *për punë të caktuara asnjë punëdhënës nuk ka pasur interes për të respektuar rregullat për sigurimin e detyrueshëm*. Trupi gjykues i Kolegjit, gjithashtu, mban në konsideratë se njëherazi me mundësitë e nënës për të siguruar të ardhura nga punësimi me kontratë të rregullt, vetë subjekti ishte në ushtrim të detyrës së gjyqtarit prej vitit 2002, për rrjedhojë situata e familjes nuk ishte në kushtet e nevojës për ekzistencë, sikundër në vitet 1992. Për sa më sipër dhe në konsideratë të qëndrimit të GjEDNj-së²⁵ për *konsiderim të rëndësishëm të faktit nëse nga personi i lidhur të ardhurat janë fituar në kohën kur subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e gjyqtarit*, trupi gjykues vlerëson se në të gjithë këndvështrimet subjekti ka dështuar të provojë ekzistencën dhe ligjshmërinë e të ardhurave të nënës, sipas parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe pretendimet e tij për zbatim të parimit të objektivitetit janë të pabazuara.

²³ Shih https://unece.org/fileadmin/DAM/pau/docs/pau/2004/PAU_2004_EPF_Sess4PresnBaldwinEdwards.pdf forumi i UNECE (United Nations Economic Commission for Europe), për Popullsinë Evropiane, zhvilluar në Gjenevë, janar 2004; Prezantim i studimit “Immigration into Greece, 1990-2003”, ku pasqyrohet se: (i) deri në vitin 1991 në Greqi nuk kishte asnjë ligj që rregullonte situatën e emigrantëve (fq.3); (ii) në vitin 1998 dalin ligjet e para që rregullojnë White Card dhe Green Card (fq. 4); (iii) në vitin 2001 del për herë të parë ligji që rregullon Work Permit për emigrantët (fq.6); (iv) në vitin 2003 emigrantët filluan të aplikojnë për Work Permit (fq.7).

²⁴ Shih <https://trainingcentre.unwomen.org/instraw-library/2010-R-MIG-ALB-MIG-AL.pdf> faqen 14: “Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë në Greqi në vitin 2001, gratë shqiptare punonin në turizëm (19 përqind), bujqësi (15 përqind), dhe industri (9 përqind); më shumë se gjysma (52 përqind) ishin të punësuar në kategorinë ‘të tjera’ kategori e cila përfshin një pjesë të madhe të punësuarash në sektorin e shërbimeve shtëpiake si pastruese shtëpish, pastruese në hotele, përkujdesje ndaj të moshuarve dhe fëmijëve, e të tjera (Baldwin-Edwards 2004).

²⁵ Shih vendimin e GjEDNj-së, çështja Sevdari v. Shqipërisë, paragraf. 88 dhe 90.

20.12. Përpos sa më sipër, në kushtet kur blerja e apartamentit parashtrohet si *nevojë për strehim e familjes*, e deklaruar me burim krijimi edhe me të ardhura të familjarëve nga puna në emigracion, kryesisht të nënës, me të cilët *ka qenë pjesë e një ekonomie familjare duke ndihmuar dhe mbështetur reciprokisht njeri-tjetrin, sipas mundësisë dhe nevojave deri në vitin 2010 (kur ka lidhur martesë)*, subjekti nuk jep asnjë shpjegim përse kjo pasuri vijon të jetë e regjistruar vetëm në emër të tij, ndërkohë që prej vitit 2014 banon më vete me bashkëshorten dhe fëmijët në një apartament tjetër, pasuri e krijuar prej tij këtë vit. Gjithashtu, konstatohet se në deklaratën e pasurisë të vitit 2004 subjekti deklaroi *ndihma e pjesëtarëve të familjes nga emigracioni, për blerje shtëpie 1.500.000 lekë*, ndërsa në deklaratën *vetting* deklaroi paguar nga nëna 700.000 lekë. Subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim për destinimin e diferencës së konsiderueshme mes dy shumave të sipërcituara, prej 800.000 lekësh, për sa gjatë hetimit administrativ nuk ka deklaruar shpenzime për mobilimin apo për punime rikonstruksioni të këtij apartamenti.

20.13. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se për shkak të vlerës relativisht të ulët të balancës negative për vitin 2004 prej (-) 350.847 lekësh, që do të rezultonte nga mospërfshirja e të ardhurave të nënës nga emigracioni, analizimi i kësaj vlere nën dritën e parimit të proporcionalitetit nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkakut shkarkimi. Trupi gjykues e vlerëson të pabazuar këtë pretendim, për sa pamjaftueshmëria e konstatuar për krijimin e një pasurie merret në konsideratë në funksion të kontrollit tërësor të kriterit pasuror për subjektin e rivlerësimit dhe, gjithashtu, balanca negative për vitin 2004 lidhet me analizën e vitit kalendarik dhe jo me analizën e burimeve për krijimin e pasurisë, e cila është fokusuar në kohën e lidhjes së kontratës.

20.14. Në përfundim të analizës sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se për pasurinë apartament me sipërfaqe 85 m², në qytetin e Korçës, viti i krijimit 2004, në vlerën 2.900.000 lekë, me pjesë takuese 100 %, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e saj, për sa nuk u provua që kredia në shumën prej 15.000 eurosh e marrë në “Alpha Bank” të ketë shërbyer si burim për krijimin e kësaj pasurie. Lidhur me burimin tjetër të deklaruar për krijimin e kësaj pasurie, të ardhurat e nënës dhe vëllait nga puna në emigracion, subjekti nuk provoi me ndonjë dokumentacion justifikues ligjor ekzistencën e tyre. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se konkluzioni i Komisionit është i drejtë dhe subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara në germen “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

*C/II Pasuria apartament me sipërfaqe 111,51 m², në qytetin e Korçës, me nr. pasurie {***} në Korçë, pjesë takuese 50 %*

- 21.** Në vendimin objekt shqyrtimi, lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit: (i) në përgjigje të rezultateve të hetimit nuk paraqiti prova për të kundërshtuar dhe rrëzuar gjetjet e Komisionit; (ii) nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të pretenduar në shumën prej 2.000 eurosh, si pagesë e këstit të parë dhe dhurimin nga vjehri në shumën prej 1.000.000 lekësh në vitin 2010; (iii) ka bërë deklaram të pasaktë për këtë pasuri dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e saj, sipas përcaktimeve të germen “b”, të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

21.1. Subjekti i rivlerësimit parashtron se pamundësinë e pagimit të shumës për këtë pasuri e konsideron rrjedhojë të një analize jo plotësisht të saktë, të kufizuar në terma të ngushtë matematikorë, duke anashkaluar dinamikën dhe fleksibilitetin e marrëdhënieve familjare në kuptim të organizimit të jetës ekonomike, dhe për shkak të disa pakujdesive të tij lidhur me deklaratimet ndër vite, për të pasqyruar kursimet e tij modeste. Lidhur me mundësitë financiare të personit tjetër të lidhur, babait të bashkëshortes, për dhënien në formën e prikës të shumës prej 1.000.000 lekësh në fund të vitit 2010, subjekti pretendon se Komisioni nuk ka bërë një vlerësim të drejtë të përgjigjeve, fakteve dhe provave të administruara, duke argumentuar si vijon:

- i) Në analizën financiare për familjen e bashkëshortes, Komisioni përfshin vetëm të ardhurat nga puna të nënës së bashkëshortes për vitet 2006-2010 dhe të bashkëshortes për vitet 2008-2010, të cilat i përlllogarit si shpenzime për jetesë duke rezultuar me bilanc negativ. Të ardhurat nga paga të personit të lidhur, bashkëshortes, para martesës, në shumën prej 569.665 lekësh janë të gjitha kursime dhe pjesë e kësaj shume, pasi shpenzimet e jetesës të saj janë përballuar nga familja.
- ii) Analiza financiare nuk merr në konsideratë të ardhurat e familjes përpara vitit 2006, mungesa e dokumentimit të tyre nuk mund të konsiderohet apriori mungesë burimesh financiare, pasi pranimi i kësaj logjike do të çonte në alogjizëm që kjo familje do të kishte pushuar ekzistencën për shkak të skamjes. Llogaritja e shpenzimeve të një familjeje në mënyrë fikse matematikore, pa marrë në konsideratë asnjë rrethanë tjetër, është një metodikë jashtë çdo realiteti objektiv.
- iii) Kursimet e familjeve të thjeshta shqiptare janë rezultat i ekonomizimit në detaj të çdo shpenzimi, prandaj është krejt pa vend “standardizimi” dhe përlllogaritja e shpenzimeve të tyre njëlloj si për familjen e subjektit deklarues/gjyqtarit.
- iv) Familjarët e bashkëshortes kanë insistuar në dhënien e kësaj shume, krijuar nga kursimet e një jete të tërë pune, për faktin se e konsideronin si kompensim për mungesën e ceremonisë së dasmës, dhuratë që në thelb ka qenë për mirëqenien e vajzës së tyre pas martese. Ka pasur detyrim të deklarojë dhuratën, por jo të bënte analizë financiare të të ardhurave të dhuruesve, të refuzonte marrjen e dhuratës apo t’u kërkonte paraprakisht të dhëna për të ardhurat. Për vetë cilësinë e dhuruesve, në kushtet e mungesës të çdo dyshimi lidhur me origjinën e kundërligjshme të kësaj shume, gjykon se është pa vend dhe në kundërshtim flagrant me parimin e sigurisë së jetës familjare kërkesa për justifikimin e burimit të kësaj shume.
- v) Komisioni pa asnjë argument nuk ka marrë parasysh një burim tjetër të të ardhurave të babait të bashkëshortes të përfituar si trashëgimtar i të atit, persekutuar politik.
- vi) Kjo shumë afekton vetëm analizën financiare të vitit 2015, i vetmi vit që janë kryer shpenzime të deklaruara me burim këtë dhurim. Në një vështrim të përgjithshëm, edhe në qoftë se kjo shumë nuk merret në konsideratë, balanca rezulton në vlerën (-) 225.540 lekë, duke mos arritur nivelin e një shkaku shkarkimi, në zbatim të parimit të proporcionalitetit.

21.2. Për sa i përket mënyrës së deklaratimit të kësaj pasurie, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në deklaratën e pasurisë *vetting* rezulton e deklaruar *apartment, nr. pasurie {***}, Korçë, me sip. 111,51 m². Burimi, kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.04.2014. Bashkëpronësi mes Olsi Xhavella e Sh. Xh. (bashkëshortja), e regjistruar si pasuri e fituar gjatë martese, pavarësisht se në cilësinë e blerësit është deklaruesi. Prona është hipotekuar në*

*favor të BKT, deri në shlyerjen e kredisë, sipas kontratës nr. {***}, datë 7.05.2014. **Burimi i krijimit:** Shuma 5.770.000 lekë e përfituar me kontratën e kredisë bankare nr. {***}, datë 07.05.2014 - paguar 2.000 euro nga kursimet vetjake (refero deklaratën e vitit 2014); - paguar 4.800 euro për efekt të shlyerjes së detyrimit të rrjedhur nga kontrata e huas nr. {***}, datë 25.04.2014, me huadhënës “{***}” ShA, huamarrës Olsi dhe Sh. Xh., për shumën 8.800 euro. Sipas deklaratës për shlyerje detyrimi nr. {***}, datë 21.10.2015, detyrimi është konsideruar i shlyer për shkak të disa të metave të sendit të pranuar nga kredidhënësi, njëkohësisht shitës i apartamentit. Burimi i shumës 4.800 euro: shuma prej 1.000.000 lekësh e dhuruar në formën e prikës në vitin 2010 (referoju deklaratës së vitit 2010). **Vlera e pasurisë çmimi i shitjes sipas kontratës 51.600 lekë Pjesa takuese: 50%.***

21.3. Pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe aktet në fashikullin e Komisionit, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim në rrethanat konkrete faktike, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson që edhe ky shkak ankimi është i pabazuar. Me shpjegimet dhe argumentet e parashtruara në ankim, të njëjta si në Komision, pretendimet e subjektit synojnë vlerësimin e rrethanave faktike, sipas një këndvështrimi, i cili bie ndesh me normat e kuadrit kushtetues dhe ligjor të rivlerësimit. Ky përfundim bazohet në analizën e shtjelluar në detaj në vijim.

21.4. Lidhur me burimin e krijimit të shumës prej 2.000 eurosh, në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi *kursimet vetjake [refero deklaratën e vitit 2014]*. Në deklaratën e pasurisë të vitit 2014, në formularin “Shpenzimet e deklarueshme”, subjekti deklaroi pagimin e shumës prej 2.000 eurosh nga kursimet vetjake në favor të shoqërisë “{***}” ShA, për efekt të kontratës së sipërmarrjes për prenotim apartamenti me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.04.2014. Gjatë hetimit administrativ, subjekti deklaroi shumën 2.000 euro nga kursimet vetjake në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitjes²⁶. Në kushtet kur në deklaratat e pasurisë të viteve pararendëse, nuk kishte deklaruar vlerë të likuiditeteve, gjendje në *cash* apo në llogari bankare, së paku në përgjigje të pyetësorit, subjekti mund të kishte shpjeguar “pasaktësitë” e deklaratave vjetore për mosdeklarimin e shumës prej 2.000 eurosh, si të krijuar nga kursimet në vite. Fakti që as në këtë moment procedural nuk ka deklaruar se kursimet ishin krijuar në vite, bëjnë që pretendimi se *për nëntë vite rezulton me bilanc pozitiv dhe diferencat që bartin një marzh të caktuar dhe të pranueshëm gabimi, të vlerësohen në raport me parimin e proporcionalitetit*, të jetë i pabazuar. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se një pretendim i tillë vjen në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9049/2003, i cili në nenin 4 vendos për zyrtarët deklarues, detyrimin për deklarimin, jo vetëm të të ardhurave, por, ndër të tjera, edhe të ndryshimeve, shtesave apo pakësimeve të kursimeve në *cash*, të realizuara gjatë vitit, si rezultat i diferencës mes të ardhurave dhe shpenzimeve. Në mbështetje të qëndrimit të konsoliduar në jurisprudencën e Kolegjit, ekzistenca e kursimeve nuk mund të prezumohet nga organet e rivlerësimit, mbështetur vetëm në pretendimin për balanca pozitive të disa viteve të periudhës objekt kontrollit, por duhet të jetë evidentuar në deklaratat periodike të interesave, të cilat shërbejnë si provë në këtë proces, në bazë të parashikimit të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Përpos sa më sipër, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se shpenzimet e jetesës që përdoren nga institucionet e rivlerësimit në funksion të analizës financiare për subjektet e rivlerësimit, sipas standardit të ILDKPKI-së dhe INSTAT-it, përbëjnë një zgjedhje tejet

²⁶ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

garantiste, janë mesatare dhe përfshijnë të gjitha shtresat e popullsisë dhe zonat e Shqipërisë, që do të thotë se ato nuk mund të përfaqësojnë shpenzimet reale të çdo individi dhe familjeje. Në këtë kuptim, ato përbëjnë një vlerë mesatare që përfaqëson një jetesë normale të një njësie familjare dhe jo shpenzime që realisht janë kryer nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit që, *në momente të caktuara, kur nevojitet kryerja e një shpenzimi është krejtësisht normale që shpenzimet e jetesës të kufizohen përkohësisht për një ose disa muaj për të "kompensuar" një shpenzim tjetër*, është i tejkaluar në kushtet kur shpenzimet mujore të përdorura si referencë përfshijnë të dhëna nga anketimet për konsumin mujor mesatar të kryer nga familjet me nivele të ndryshme të ardhurash, duke standardizuar dhe unifikuar këto shpenzime, pra, të familjes së një gjyqtari me një familje me të ardhura shumë më modeste. Sa më sipëranalizuar, balancat pozitive që rezultojnë vitet e mëparshme, në vlera jo të konsiderueshme²⁷, nuk mund të pretendohen si kursime *de facto*, për rrjedhojë nuk ka shkak për të pretenduar për zbatim të parimit të proporcionalitetit.

21.5. Lidhur me mundësitë e familjes së bashkëshortes për të dhuruar shumën prej 1.000.000 lekësh në vitin 2010, konstatohet se analiza financiare e kryer në Komision nuk është *thjesht matematikore*, siç pretendon subjekti, por merr në konsideratë të ardhurat e ligjshme të anëtarëve të familjes, sipas kriterëve të parashikuara në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Për babain e bashkëshortes, subjekti deklaroi se ka siguruar të ardhura nga puna në emigracion në Greqi në vitet 1991-1994 dhe në vijim duke ushtruar profesionin e saldatorit, me porosi të ndryshme dhe për nënën e bashkëshortes para vitit 2006, si e punësuar në subjekte private e pasiguruar. Në këtë situatë faktike, pretendimi i subjektit që në analizën financiare të konsiderohen këto të ardhura është haptazi i pabazuar, për sa norma kushtetuese përcakton se *subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore*. Mungesa e burimeve të ligjshme financiare nuk "përkthehet" në mungesë të burimeve financiare të familjes e, për rrjedhojë, pretendimet e subjektit *se pranimi i mungesës së burimeve financiare do të çonte në alogjizëm se familja do të kishte pushuar ekzistencën për shkak të skamjes*, vlerësohet jorelevant përkundrejt përmbushjes së detyrimit për të provuar ligjshmërinë e shumës prej 1.000.000 lekësh.

21.6. Lidhur me pretendimin se përlllogaritja e shpenzimeve të jetesës së familjes së bashkëshortes nuk mund të jetë e njëjtë me përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës së një gjyqtari, për shkak të standardeve të ndryshme të jetesës, në konsideratë të qëndrimit të konsoliduar të Kolegjit²⁸ dhe për sa analizuar edhe në paragrafin 21.4. më lart, trupi gjykues i Kolegjit çmon të risjellë në vëmendje si vijon. Kostot e shpenzimeve të jetesës, përdorur nga Komisioni si referencë për familjen e bashkëshortes së subjektit, janë standard i përdorur nga organet e rivlerësimit në të gjithë rastet e subjekteve të tjerë të rivlerësimit, për personat e tjerë të lidhur dhe përfshijnë të dhëna nga anketimet për konsumin mujor mesatar të kryer nga familjet me nivele të ndryshme të ardhurash, si emërues i përbashkët që përfshin gjithë fashat e pagave dhe përfitimeve në Republikën e Shqipërisë. Sa më sipër, si për të gjithë rastet e tjerë,

²⁷ Në analizën financiare të Komisionit, rezultojnë me balancë pozitive respektivisht, viti 2011 në vlerën 451.969 lekë, viti 2012 në vlerën 10.480 lekë dhe viti 2013 në vlerën 363.909 lekë.

²⁸ Shih vendimet e Kolegjit nr. 29/2020(JR) dhe nr. 31/2023(JR).

përllogaritja e shpenzimeve të jetesës për familjen e bashkëshortes së subjektit përbën një zgjedhje tejet garantiste, pavarësisht nga niveli i të ardhurave i anëtarëve të familjes.

21.7. Të pabazuar e vlerëson trupi gjykues edhe pretendimin tjetër të subjektit se në kontekst të çfarë shuma përfaqëson, cilësinë e dhuruesve me lidhje krushqie, kërkesa për justifikimin e burimit të shumës së dhuruar vjen në kundërshtim me parimin e sigurisë së jetës familjare. Ligji nr. 84/2016, në nenin 32, pika 4, parashikon qartë detyrimin për subjektin e rivlerësimit, personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, parashikim i cili nuk bën asnjë dallim për raste të lidhjeve familjare apo miqësore.

21.8. Lidhur me pretendimin se Komisioni pa asnjë argument nuk ka marrë parasysh burimin tjetër të të ardhurave, të përfituar nga babai i bashkëshortes i tij si trashëgimtar i të atit, i persekutuar politik, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, megjithëse deklaroi se Drejtorja e Pagesave dhe Dëshmipërblimeve ka shpërndarë tri këste takuese të dëshmipërblimit financiar kundrejt subjekteve përfituese në mënyrë proporcionale, nuk referon në terma konkretë sa është vlera e përfituar prej babait të bashkëshortes së tij. Referuar burimeve të hapura²⁹, këstet e dëshmipërblimit për shumën prej 3.379.018 lekësh për trashëgimlënësin, si i persekutuar politik, janë përfituar nga katër trashëgimtarë, një prej të cilëve vjeçri i subjektit. Sa më sipër, konsideruar se janë shpërndarë vetëm tri këste dhe jo shuma e plotë, të ndara mes trashëgimtarëve, pavarësisht raportit të pjesëve midis tyre, në çdo rast vlerat e përfituara prej babait të bashkëshortes nuk do të kishin peshë në balancën negative të analizës financiare të familjes. Përpos sa më sipër, shumat e përfituara nga dëshmipërblimi janë shpërndarë në llogaritë bankare të përfituesve të tyre e, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit mund t'i provonte ato edhe përmes vërtetimit apo lëvizjes së llogarisë bankare. Në përfundim, mosparaqitja prej subjektit e asnjë dokumenti, nga Ministria e Financave apo banka përkatëse, që të provojë përfitimin e këtyre të ardhurave, e vendos atë në kushtet e mospërmbushjes së barrës së provës e, për rrjedhojë, pretendimi i tij lidhur me këto të ardhura mbetet i paprovuar.

21.9. Subjekti pretendon se shuma prej 1.000.000 lekësh afekton vetëm analizën financiare të vitit 2015, i vetmi vit me shpenzime të deklaruara me burim këtë dhurim. Në deklaratën vetting, lidhur me burimet e krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 111,51 m², në Korçë, subjekti deklaroi se, për efekt të shlyerjes së detyrimit prej 8.800 eurosh të rrjedhur nga kontrata e huas me nr. {***}, datë 25.04.2014, huadhënës shoqëria “{***}” ShA [shoqëria ndërtuese], ka paguar shumën prej 4.800 eurosh. Ndërsa pjesa tjetër e detyrimit, për shkak të disa të metave të sendit të pranuar nga kredithënësi, është konsideruar e shlyer, sipas deklaratës për shlyerje detyrimi nr. {***}, datë 21.10.2015. Burimi i krijimit të shumës 4.800 euro, deklarohet shuma prej 1.000.000 lekësh e dhuruar nga vjeçri. Në deklaratën e pasurisë të vitit 2015, subjekti deklaroi shlyerjen e huas ndaj shoqërisë “{***}” ShA, sipas deklaratës noteriale nr. {***}, datë 21.10.2015, me pagesën e 4.800 eurove dhe riparimin e disa të metave të sendit të pranuar nga kredithënësi, në vijim, deklaroi shpenzim 300.000 mijë lekë për disa punime shtesë dhe mobilim të apartamentit, me burim krijimi shumën 1.000.000 lekë të

²⁹ Shih <https://financa.gov.al/informacion-per-kategorine-jo-paresore/>
<https://gazetashqiptare.al/2019/05/23/ish-te-perndjekurit-gati-kesti-trete-per-900-trashegimtare/>

dhuruar nga vjehri. Gjatë hetimit administrativ³⁰, subjekti ka deklaruar se shuma e dhuruar nga vjehri prej 1.000.000 lekësh është shpenzuar për të paguar në datën 21.10.2015, vlerën prej 4.800 eurosh dhe për disa punime shtesë dhe mobilimin e apartamentit në vitin 2015 në shumën prej 300.000 lekësh dhe ndonjë diferencë e vogël që rezulton, duke zbritur dy shpenzimet e kryera më lart, duhet të jetë shpenzuar për nevoja familjare. Sa më sipër, subjekti barasvlerëson termat *riparimi i të metave të sendit* dhe *punimet shtesë*, shpenzime të cilat i deklaroi me burim shumën e dhuruar prej 1.000.000 lekësh.

21.10. Në përmbajtje të deklaratës noteriale, me nr. {***}, datë 21.10.2015, palët deklarojnë shlyerjen e shumës totale të huas prej 8.800 eurosh, 4.800 eurosh në *cash*, pa specifikuar saktësisht kohën e shlyerjes dhe bien dakord që pjesa tjetër prej 4.000 eurosh të konsiderohet e shlyer për shkak të riparimit prej subjektit dhe bashkëshortes *të disa të metave që kishte hyrja e apartamentit*³¹. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti deklaroi se ka filluar të banojë në këtë apartament prej vitit 2015³², ndërsa në deklaratën e pasurisë të vitit 2016 apartamenti deklarohet prej subjektit si vendbanim alternativ. Referuar deklaratës së subjektit se ka filluar të banojë në këtë apartament nga fillimi i vitit 2015, sikundër kuptohet qartë, *riparimet* apo *punimet shtesë që kishte hyrja e apartamentit* do të jenë kryer përpara vitit 2015, për sa nuk duket bindëse kryerja e punimeve shtesë në një apartament të banueshëm. Përpos sa më sipër, në përgjigje të pyetësorit standard, lidhur me shpenzimet për mobilim të këtij apartamenti, subjekti deklaroi se *fillimisht pas hyrjes në të, kemi investuar një shumë prej 300.000 lekësh për arredim për plotësimin e nevojave bazike për jetesë (deklarim i vitit 2015), duke e pasuruar pas vitit 2015 dhe deri më tani me shpenzime të kryera vit pas viti*, ndërsa për mënyrën e shpenzimit të shumës së pretenduar të dhuruar nga vjehri, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, deklaroi se *janë paguar më datë 21.10.2015 (vërtetuar me deklaratë për shlyerje detyrimi datë 21.10.2015), 4.800 euro për efekt të pagimit të çmimit të apartamentit që nuk mbulohej në momentin e hartimit të kontratës së shitjes. Janë shpenzuar 300.000 lekë për disa punime shtesë dhe mobilimin e apartamentit (pasqyruar në deklaratën e vitit 2015). Lidhur me këtë shpenzim nuk disponoj fatura për blerjen e pajisjeve të mobilimit apo punimeve të kryera në banesë*. Për rrjedhojë, pavarësisht deklaratimeve jokonsistente të subjektit, në çdo variant të pretenduar, shuma prej 300.000 lekësh ka qenë e pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet për mobilim dhe *riparim të të metave* apo *punimet shtesë* në apartament me kosto prej 4.000 eurosh e, për më tepër, që këto punime rezulton të jenë kryer përpara vitit 2015.

³⁰ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

³¹ Në përmbajtje të deklaratës pasqyrohet se: “Në ditën e sotme përfaqësuesi i shoqërisë deklaroi se është shlyer plotësisht prej blerësve në shumën prej 4.800 eurosh dhe me marrjen e kësaj shume jam likuiduar plotësisht ditën e sotme për apartamentin që ju kam shitur. Për sa i përket shumës tjetër prej 4.000 eurosh ne e kemi zgjidhur, pasi hyrja e apartamentit kishte disa të meta të cilat janë riparuar prej blerësve Olsi dhe Sh. Xh. dhe kjo shumë është zbritur nga kontrata e huas. Nga ana e tyre Olsi dhe Sh. Xh. deklarojnë se kanë shlyer shumën prej 4.800 eurosh shoqërisë “{***}” ShA, shumë e cila rrjedh nga kontrata e huas me nr. {***}, datë 25.04.2014. Ndërsa për shumën prej 4.000 eurosh nuk kemi asnjë detyrim ndaj shoqërisë “{***}” ShA, për shkak se këtë shumë e kemi shpenzuar për disa të meta që kishte sendi të kryera në kryera në hyrjen e apartamentit të blerë prej shoqërisë “{***}” ShA dhe kjo shumë është zbritur nga kontrata e huas.

³² Në përgjigje të pyetjes 1 “A keni jetuar në adresën që është shënuar në zyrat e gjendjes civile apo në atë që keni shënuar në vetëdeklarim në shtatë vitet e fundit(respektivisht 2011-2017)?” subjekti deklaroi: “Prej vitit 2004 deri në vitin 2015, kam banuar në adresën që prej meje por edhe gjithë banorëve të pallatit njihej si: L. {***}, rr: “{***}”, pallati përballë Bashkisë, {***}, Korçë. Prej vitit 2015 dhe aktualisht, banoj në adresën rr: “{***}”, pall. {***}, {***}, Korçë.

22. Në përfundim të sa analizuar më sipër, për pasurinë apartament me sipërfaqe 111,51 m², në qytetin e Korçës, viti i krijimit 2014, me vlerë 51.600 euro, pjesë takuese 50 % [pasuri e krijuar gjatë martesës], trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e saj. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi: (i) mundësitë financiare të tij dhe personit të lidhur, bashkëshortes, për të kryer pagesën e këstit të parë prej 2.000 eurosh në datën 02.04.2014; (ii) burimin e ligjshëm të shumës prej 1.000.000 lekësh, deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2010, si dhuratë nga familja e personit të lidhur, bashkëshortes, në formën e prikës, e cila është deklaruar si një prej burimeve për shlyerjen e çmimit të shitjes së paguar për këtë pasuri - detyrimin sipas kontratës së huas me shoqërinë ndërtuese. Për rrjedhojë, subjekti gjendet në kushtet e parashikuara në germën “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

*C/III Në lidhje me automjetin tip BMW, me targa {***}, blerë në datën 14.06.2003, në vlerën 250.000 lekë, shitur në datën 26.05.2006, në po të njëjtën vlerë*

23. Komisioni ka konkluduar se *subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm për blerjen e kësaj pasurie dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, sipas përcaktimeve të germës “b”, të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të përmbysë barrën e provës për të provuar mundësitë financiare për blerjen e automjetit në vitin 2003, në vlerën prej 250.000 lekësh, ku si burim ka deklaruar të ardhurat e nënës dhe vëllait nga emigracioni.*

23.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton sa konkluduar prej Komisionit dhe parashtron se lidhur me mundësitë financiare të nënës nga të ardhurat nga emigracioni i qëndron të njëjtave argumente si për pasurinë apartament me sipërfaqe 85 m², në Korçë. Subjekti pretendon se, edhe duke mos u marrë në konsideratë dhurata e dhënë, analiza financiare për vitin 2003 Komisionit i ka rezultuar me balancë pozitive në shumën prej 222.991 lekësh, për vitin 2002, kur ka filluar punë, për shkak të mënyrës së njëjtë të jetesës *rezulton me bilanc pozitiv*, për rrjedhojë blerja e kësaj pasurie ka qenë, jo vetëm e përballueshme, por duhet të kishte akumuluar edhe kursime. Subjekti potencon se këtë pasuri në thelb e justifikon edhe me të ardhurat e tij, tepricat e të cilave nuk i ka deklaruar as si kursime dhe as si burim i ndonjë shpenzimi tjetër, çka logjikisht çon në përfundimin se *nuk ka pasur asnjë interes për deklarimin e një burimi tjetër për blerjen e automjetit*, përpos arsyes së vetme të deklarimit me vërtetësi dhe përmbushjes së detyrimit ligjor për deklarim të dhuratave, prandaj nuk e gjen me vend mospërfshirjen e çmimit të shitjes në analizën financiare të vitit 2006, pavarësisht se analiza financiare edhe nga kjo mospërfshirje rezulton me balancë pozitive.

23.2. Në deklaratën e rivlerësimit *vetting*, subjekti deklaroi se aktualisht nuk disponon pasuri të luajtshme dhe deklaroi historikun e automjeteve në pronësi të tij për periudhën objekt kontrolli. Për këtë automjet deklarohet *blerë me kontratën nr. {***}, datë 14.06.2003* [pa vlerë dhe burim krijimi]. Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, lidhur me këtë automjet, subjekti, përpos kontratës së shitjes nr. {***}, datë 14.06.2003, deklaroi burimin e krijimit të *ardhurat e siguruara nga emigracioni të nënës dhe vëllait nga viti 1992* dhe nuk deklaroi pjesë takuese.

23.3. Trupi gjykues i Kolegjit i vlerëson edhe këto pretendime të subjektit të pabazuara. Lidhur me të ardhurat e nënës nga emigracioni, trupi gjykues ka analizuar gjerësisht në rastin

e pasurisë apartament me sipërfaqe 85 m,² në Korçë. I njëjti qëndrim vlen edhe për të ardhurat e vëllait nga emigracioni, punësimi i të cilit nuk ka qenë i vijueshëm, sipas deklarimit të subjektit. Pretendimi për të konsideruar mundësitë e tij financiare, vlerësohet i pabazuar për sa burimi i pasurisë është deklaruar në deklaratën vjetore të pasurisë, që ka vlerën e provës në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe nuk mund të pretendohet i ndryshëm, sipas parashikimeve të të njëjtit ligj.

23.4. Në përmbyllje, trupi gjykues i Kolegjit, duke konsideruar pretendimet e subjektit të pabazuara, konstaton se ky konkluzion nuk i ka dhënë pasojë subjektit në vlerësimin tërësor të kryer prej Komisionit, për rrjedhojë, cilido qoftë përfundimi për këtë pasuri, nuk do të kishte peshë në shqyrtimin e vendimit objekt ankimi.

Për analizën financiare 2003-2016

24. Në drejtim të analizës financiare, trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit se *nuk i janë marrë në konsideratë të gjitha vërejtjet që ka ngritur gjatë hetimit administrativ, marrja e tyre në konsideratë rrezon balancat negative për secilin vit të evidentuar.* Subjekti pretendon se *balanca negative e evidentuar për shumën e përgjithshme (1.396.988) lekë, e ndarë në katër vite, është e ekzagjeruar dhe rezultat i gabimeve në llogaritje dhe mosvlerësimin të drejtë të gjithë zërave financiarë që përcaktojnë të ardhurat dhe shpenzimet vit pas viti.* Për këto argumente, subjekti kërkon nga Kolegji rishikimin e plotë të analizës financiare për vitet me balancë negative. Trupi gjykues mori fillimisht në analizë pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të cilat fokusohen në zëra specifike financiarë të secilit vit, dhe, më tej, pretendimet për të gjithë vitin përkatës.

24.1. Në lidhje me analizën financiare të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit pretendon se diferenca e të ardhurave me shpenzimet është pozitive dhe rezultati negativ buron nga pasqyrimi i zërit “ndryshim në likuiditet”, për shumën 946.956 lekë. Subjekti pretendon se, *nëse shuma e dhuruar nga familja e bashkëshortes, prej 1.000.000 lekësh, nuk njihet për shkak të pamundësisë financiare të dhuruesve, si dhe faktit që nuk ka shërbyer për krijimin e ndonjë pasurie apo kryerjen e ndonjë shpenzimi në vitin korrespondues, atëherë nuk duhet të merret në konsideratë dhe, si rrjedhojë, pjesë e analizës financiare mbeten të ardhurat e tjera.*

24.2. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se në vendimin objekt shqyrtimi pasqyrohet hetimi administrativ lidhur me burimet e ligjshme dhe mundësitë financiare për krijimin e shumës prej 1.000.000 lekësh, të deklaruar si dhurim nga babai i bashkëshortes, barrën e provës së kaluar subjektit për të provuar dhe për të dokumentuar bindshëm mundësitë financiare të vjehrrit të tij për këtë dhurim. Bazuar në shpjegimet dhe provat e paraqitura prej subjektit, Komisioni ka kryer analizën financiare për mundësitë e familjes së bashkëshortes së subjektit, sipas të ardhurave të dokumentuara të anëtarëve të familjes prej vitit 2006 deri në maj 2010,³³ nga e cila ka rezultuar balancë negative në vlerën prej (-) 1.091.177 lekësh. Për rrjedhojë, Komisioni ka konkluduar se prindërit e bashkëshortes kanë qenë në pamundësi për dhënien e shumës prej 1.000.000 lekësh në formën e prikës. Përkundër këtij përfundimi, përfshirja nga Komisioni në

³³ *Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shuma është dhënë menjëherë pas martesë dhe ardhjes në jetë të djalit, ndodhur në mënyrë të njëkohshme. Nga aktet në fashikuj rezulton se subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë në maj 2010.*

analizën financiare të vitit 2010 të shumës prej 1.000.000 lekësh si gjendje *cash*, përpos e pakuptimtë, është e pabazuar. Në deklaratën e pasurisë të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit e deklaroi shumën prej 1.000.000 lekësh si *dhuratë në formën e prikës nga vjehri*, dhe përfshirja e kësaj vlere si gjendje *cash* në analizën financiare të këtij viti, për sa subjekti nuk e deklaroi si të tillë dhe nuk janë kursime të krijuara prej tij, deformon burimin e krijimit dhe rëndon analizën financiare të këtij viti. Në kontrollin e kryer në Kolegj të analizës financiare të Komisionit për vitin 2010, kjo shumë nuk u përfshi dhe, për rrjedhojë, balanca rezultoi pozitive në vlerën prej 439.098 lekësh.

24.3. Në lidhje me analizën financiare të vitit 2014, e cila, sipas Komisionit, rezultoi me balancë negative në shumën prej (-) 260.698 lekësh, subjekti i rivlerësimit pretendon se është i pasaktë evidentimi si vlerë negative në shumën prej (-) 453.000 lekësh i zërit të emërtuar në këtë analizë "*Hua nga SH.P.K. {***} - Sh. Xh. - 500.000 lekë*".

24.4. Nga kontrolli i akteve të administruara në fashikuj, konstatohet se bashkëshortja e subjektit, sipas kontratës së huas, datë 09.08.2013, huadhënës SH.P.K. {***} [emërtuar më pas SHPK "{***}"] ka marrë hua shumën prej 500.000 lekësh, me afat shlyerjeje 2 vjet, kështu mujor 24.500 lekë. Më datë 29.04.2014, huamarrësja lidh një kontratë të re huaje me këtë shoqëri, për likuidimin e shumës së mbetur pa shlyer nga kredia e datës 09.08.2013. Nga kontrolli i dokumentacionit të kredisë së parë³⁴, rezultoi se:

- në datën 29.04.2014, shuma e mbetur nga principali i kredisë ka qenë 350.500 lekë, ndërsa subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të pabazuar, pretendon se kjo shumë ka qenë 330.000 lekë;
- në periudhën janar-prill 2014, kështu e kredisë janë shlyer sipas kushteve të kontratës së datës 09.08.2013³⁵, për muajt e tjerë të vitit, kështu e kredisë janë shlyer sipas kushteve të kontratës së datës 29.04.2014³⁶. Krahas shlyerjes së kësteve të kredive, shpenzimet këtë vit kanë përfshirë edhe shlyerjen e principalit të mbetur dhe interesit për kredinë e parë. Principali i mbetur i kredisë së parë, prej 350.500 lekësh është shlyer pjesërisht me shumën e kredisë së dytë prej 330.000 lekësh dhe diferenca prej 20.500 lekësh nga të ardhurat e subjektit.

24.5. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit se gjatë vitit 2014, për kredinë e parë, shpenzim real i kryer janë vetëm shlyerjet e katër kësteve mujore vlerësohet i pabazuar, për sa shuma e kredisë së dytë e përdorur për shlyerjen e principalit të kredisë së parë, përfaqëson të ardhura të personit të lidhur të shpenzuara për nevoja të tij. Thënë ndryshe, pretendimi se konsiderimi i mbylljes së kredisë si shpenzim ka rënduar balancën financiare në shumën prej (-) 453.000 lekësh, është i pabazuar dhe vlerësimi prej Komisionit i shumës së kredisë së dytë si shpenzim i kryer për vitin 2014 është i drejtë. Gjithashtu, në Kolegj u krye kontrolli i analizës financiare të Komisionit për vitin 2014, i cili konfirmoi balancën negative në të njëjtën vlerë sikundër Komisioni.

24.6. Në lidhje me analizën financiare të viteve 2004 dhe 2015, pretendimet e subjektit të rivlerësimit u fokusuan në zbritjen e shpenzimeve të jetesës për ditët që ka qenë në Greqi të të

³⁴ *Kalendar i shlyerjes së kredisë, Aneksi 4/7, dosja e ILDKPKI-së.*

³⁵ *Për periudhën janar - prill 2014, shpenzimet e kredisë janë: 24.500 [kësti mujor] *4 = 98.000 lekë*

³⁶ *Për periudhën maj - dhjetor 2014, shpenzimet e kredisë janë: 10.000 [kësti mujor] *8 = 80.000 lekë.*

afërmit, si i mikpritur prej tyre, si dhe zbritjen e shpenzimeve të jetesës për ditët që ka deklaruar se, për arsye pune, delegime pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër, ka zgjedhur të përshkojë një pjesë të itinerarit përmes territorit grek, për shkak të infrastrukturës e për të cilat ka përfituar dieta.

24.7. Sikundër analizuar më lart, Komisioni në vendim është shprehur qartë se *në rastet kur qëndrimi është deklaruar dhe vërtetuar me dokumentacion shkresor te familjarët e subjektit/bashkëshortes, nuk janë llogaritur shpenzime qëndrimi*, për rrjedhojë pretendimi i subjekti në këtë aspekt vlerësohet jo i bazuar. Sa i përket udhëtimeve për qëllime pune, i deleguar pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër, sipas deklarimeve të subjektit në pyetësonin standard, rezulton se janë më pak se dhjetë ditë, në vitet 2015-2017 e, për rrjedhojë, pesha e tri udhëtimeve të deklaruara me këtë qëllim në vitin 2015 nuk do të kishte asnjë ndikim në analizën financiare të këtij viti.

24.8. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se analiza financiare për vitin 2015, pëson ndryshim nëse merren parasysh, qoftë edhe në mënyrë të pjesshme pretendimet e tij lidhur me ligjshmërinë e dhuratës së dhënë në formën e prikës në vitin 2010, e cila është deklaruar e shpenzuar në vitin 2015. Për sa analizuar në paragrafin 24.2 të këtij vendimi, trupi gjykues i Kolegjit gjen të pabazuar konsiderimin e shumës prej 1.000.000 lekësh në analizën financiare të Komisionit, si gjendje *cash* për vitet 2011-2014 dhe si pakësim në vitin 2015. Në kontrollin e kryer në Kolegj të analizës financiare të Komisionit për vitet 2011-2015, mospërfshirja e shumës prej 1.000.000 lekësh afekton vetëm balancën e vitit 2015, pasi në këtë vit subjekti deklaroi përdorimin e kësaj shume si një nga burimet për krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 111,51 m² dhe për shpenzime mobilimi. Për rrjedhojë, viti 2015 rezulton në një balancë negative prej (-) 1.224.541 lekësh, në ndryshim nga analiza e Komisionit balanca e të cilit ka rezultuar (-) 224.451 lekë.

24.9. Në përmbledhje, nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit të kryer në Kolegj, për periudhën 2003-2016, balanca negative thellohet duke shkuar në vlerën (-) 1.836.086 lekë, përkundrajt vlerës prej (-) 1.396.988 lekë sipas Komisionit, në reflektim të shkakut të ankimit të paraqitur nga subjekti për analizën financiare të vitit 2010, të cilin trupi gjykues, sipas arsytimit të trajtuar në paragrafin 24.2, e ka konsideruar të bazuar. Nga katër vitet me balancë negative në analizën financiare të Komisionit, respektivisht 2004, 2010, 2014 dhe 2015, nga kontrolli i kryer në Kolegj, balanca e viteve 2004 dhe 2014 nuk ndryshon. Sa i përket viteve 2010 dhe 2015, balancat ndryshuan respektivisht, për vitin 2010 nga vlera (-) 560.903 lekë në vlerën 439.098 lekë; dhe për vitin 2015 nga vlera (-) 224.451 lekë në vlerën (-) 1.224.541 lekë. Këto ndryshime vijnë si rrjedhojë e korigjimit të analizës financiare dhe mospërfshirjes të shumës prej 1.000.000 lekësh. Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, për blerjet e pasurive, shtimin e likuiditetit dhe shpenzimet e kryera, sipas përcaktimeve të germës “b”, të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

25. Në përfundim, trupi gjykues, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, në zbatim të nenit D, pikat 1, 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016, vlerëson se vendimi nr. 375, datë 18.03.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjendet i drejtë e i bazuar në fakte, në prova dhe në ligj.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 357, datë 18.03.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Olsi Xhavella.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 07.02.2024, në Tiranë.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi